



LYRA

REVISTË PERIODIKE E FESTIVALIT FOLKLORIK MBARËKOMBËTAR

“I KËNDOJMË LIRISË”

24

VJET

FESTIVAL

ELEZAJ:

“Festivali "I Këndojmë Lirisë" lindi nga ideja për ta mbajtur të gjallë kujtimin e luftës sonë çlirimtare dhe për ta përjetësuar veprën e Komandant Mujë Krasniqi dhe të gjithë atyre që sakrifkuan jetën për lirinë që ne sot gëzojmë”... .

HARADINAJ:

“Mujë Krasniqi, bashkë me Beqir Gashin dhe bashkëluftëtarët tjerë, përmes këngës u jepnin zemër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare”... .

BUZHALA:

“Liria është dashuria që ndajmë si copën e bukës. Është kënga që nuk shuhet kurrë. Le të festojmë së bashku, me zemër, me këngë, me shpresë”.

2026

Klina në festën e Festivalit

Në Çabiq e Klinë, jehoi kënga dhe vallja gjithëkombëtare

LIRI PËR ÇLIRIMTARËT

Editorial

KLINA NË FESTËN E FESTIVALIT "I KËNDOJMË LIRISË"

Enver MALOKU



Qershori është muaj i lirisë në Kosovë. Në këtë muaj është çliruar Kosova. Në këtë muaj u përmyll njëri ndër kapitujt më të lavdishëm të gjakimit të paseshtur për çlirimin e vendit. Klina, sivjet si edhe viteve të tjera ka festë të dyfishtë, jetën në liri dhe përjetimin e festivalit mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë". Tashmë që 24 vjet, për çdo vit më 6, 7 dhe 8 qershor mbahet Festivali Folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë". Për tri netë me radhë këndohet e vallëzohet lirshëm. U këndohet heronjve, dëshmorëve, Adem Jasharit, Mujë Krasniqit e të tjerëve Lufta kishte përfunduar, liria ishte fituar, por pasojat akoma ndihen. Armiku ishte dëbuar nga trojet tona, falë trimërive heroike të pjesëtarëve të UÇK-së, me përkrahjen e Amerikës mike e miqve tjerë ndërkombëtar. Armiku ishte shporrur duke lënë kockat në tokën e Arbrit. Por Liria është e shtrenjtë, ashtu ishte paguar. Për te kishin rënë luftëtarët, për mos të vdekur kurrë. Kujtohen brez pas brezi. Me pushkë e me këngë edhe në front, kishin rënë me këngë në gojë.

Armiku aq sa i frikësohej pushkës, po aq i frikësohej, këngës, çiftelisë, plisit. Në gjithë këtë përjetim të lirisë në Klinë mbahet Festivali mbarëkombëtar folklorik "I Këndojmë Lirisë". Festa është e kuptueshme. Në skenë ngjiten ansamble, këngëtarë, valltarë, instrumentistë nga të gjitha trojet shqiptare. Kështu është edhe sivjet. Janë mëse 30 ansamble, rapsodë që shpalosin vlerat e tyre artistike. Kostumet janë të larmishme nga të gjitha trevat shqiptare. Festivali Folklorik gjithëkombëtar figurën madhore të njërit nga komandantët më të shquar të UÇK-së, Komandant Mujë Krasniqin-Kapuçin. Kështu nis Festivali Folklorik gjithëkombëtar, fillimisht në vendlindjen dhe ditëlindjen e Komandant Kapuçit, më 6 qershor në Çabiq, për të vazhduar për tri net radhazi, më 6, 7 e 8 qershor në qytetin e Klinës, ku i këndohet luftës së UÇK-së, veprës së lavdishme të Mujë Krasniqit, Komandantit legjendar Adem Jasharit, dëshmorëve të kombit e gjithë e heronjve të luftërave çlirimtare ndër

shekuj. Festivali për çdo vit ka shënuar rritje, si për nga cilësia po ashtu edhe për nga masivizimi. Kështu tash pothuajse për çdo vit marrin pjesë për tri net rreth 700 artistë. Festivali ka karakter garues, kurse ndahen 15 çmime, kryesori është i "Mujë Krasniqit", vendi i dytë, vendi i tretë, grupi më i kompletua, veterani i festivalit, instrumentisti më i mirë, vallja më e mirë, koreografia më e mirë, e kështu me radhë. Për tri net juria profesionale vlerëson garuesit. Festivali Folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë", mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj.

Redaksia:

Enver Maloku, kryeredaktor

Sadri Haxhaj, redaktor

Bedri Morina, gazetar-lektor

Dardan Kabashi, fotograf

Taulant Berisha, design

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

NË ÇABIQ TË KLINËS U HAP FESTIVALI FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË"

Enver MALOKU

Në Çabiq të Klinës, në vendlindjen e komandantit të shquar të UÇK-së, Mujë Krasniqit-Kapuçit, pranë Kullës muze, solemnisht nisi edicioni i 24-të Festivalit Mbarëkombëtar Folklorik "I Këndojmë Lirisë", i cili pastaj në mbremje ka vazhduar për tri netë më radhë, më 6, 7 e 8 qershor në sheshin Mujë Krasniqi në qytetin e Klinës. Më këtë rast merrnin pjesë personalitete të shquara të jetës politike e ushtarake të Kosovës, bashkëluftëtarë të Mujës si dhe qytetarë të shumtë të cilët kishin ardhur në hapjen solemne të këtij festivali. Hapjen solemne e bëri kryetari Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i cili ndër tjera tha se:

"Si çdo vit, ky festival nis pikërisht këtu, në këtë vend që lindi dhe rriti një nga figurat më emblematike të luftës sonë çlirimtare. Kjo tokë ka lindur burra që i dolën zot atdheut në ditët më të vështira, burra që lirinë e Kosovës e vunë mbi jetën e tyre dhe që me sakrificën e tyre shkruan faqet më të ndritura të historisë sonë kombëtare.

Sot nuk jemi mbledhur vetëm për të hapur një festival. Jemi mbledhur për të nderuar të kaluarën tonë, për të kujtuar dëshmorët e kombit dhe për të ruajtur amanetin e tyre. Festivali "I Këndojmë Lirisë" lindi nga ideja për ta mbajtur të gjallë kujtimin e luftës sonë çlirimtare dhe për ta përjetësuar veprën e Komandant Mujë Krasniqit dhe të gjithë atyre që sakrifkuan jetën për lirinë që ne sot gëzojmë".

Elezaj theksoj se, Festivali "I Këndojmë Lirisë" është festival i kujtesës sonë kombëtare, i vlerave kombëtare dhe i traditave tona. Njëjtë sikur Muja që i këndonte heronjve dhe luftëtarëve për liri, edhe sot këtu e në tri netë në sheshin

Mujë Krasniqi në Klinë, rapsodët me këngë, çifteli e sharki do t'i këndojnë Mujës, Alisë, dëshmorëve e heronjve të kombit dhe luftës së lavdishme të UÇK. "Komuna e Klinës ndihet krenare që është shtëpia e këtij festivali, që përmes këtij manifestimi ruajmë jo vetëm kujtimin për Komandant Mujë Krasniqin dhe bashkëluftëtarët e tij, por edhe thesarin e pasur të kulturës sonë kombëtare. Për tri ditë me radhë, Klina do të jetë kryeqendra e folklorit shqiptar. Këtu do të mblidhen zërat më të mirë të këngës burimore, grupet artistike, valltarët e rapsodët që me talentin dhe përkushtimin e tyre i japin jetë këtij festivali. Festivali "I Këndojmë Lirisë" ka edhe karakter garues", theksoi Elezaj.

Hapjen e festivalit e ka përshëndetur edhe ish bashkëluftëtarë Mujë Krasniqit, ish-komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj i cili ndër tjera tha se Muja nuk ishte vetëm i Çabiqit, por i gjithë Kosovës, i gjithë shqiptarisë. Ai gjendej aty ku ishte më vështiri, ishte edhe në Dukagjin. "Mujë Krasniqi, bashkë me Beqri Gashin dhe bashkëluftëtarët tjerë, përmes këngës u jepnin zemër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare, shpresë e besim për fitore. Heroi që i këndoi lirisë në robëri, mbetet frymëzim që vlerat tona kombëtare të jetojnë gjithmonë", tha Haradinaj.

Në emër Çabiqit, përfaqësuesi këtij fshati, shkrimtari e kritikuar letrar Prend Buzhala të pranishmëve u dëshiroj me shprehjen tradicionale shqiptare "Mirë se keni ardhur, mirë se ku pru Zotit". Ai tha se tashmë Festivali "I Këndojmë Lirisë", i 24-ti me radhë, është pjesë e festave të Klinës dhe Çabiqit, pjesë e

kalendarit kombëtar kulturor.

"Ky fshat, ndër festivale i pret me moton "Mirë se ju ka pru Zotit. Shpia asht e mikut dhe e Zotit", ashtu siç është shtruar kjo sofër te kjo Kullë, nga e cila, dikur dëgjohej Kënga e Mujës dhe fluturonin Pëllumbat e Bardhë të Mujës, simbole paqeje, pastërtie dhe vigjilence. Nëpër festivale rrugëve të këtij fshati kanë defiluar e vallëzuar valltarë nga të gjitha trojet etnike. Qe dy dekada ende do të jehojnë vargjet e një kënge: Kreshtat e Kosovës kanë marrë ngjyrë të kuqe. Krushqit e Dardanit janë nisë me marrë nuse.

Liria është ajo që të jesh vetvetja, mes njerëzve të tu, me kulturën tënde, me gjuhën tënde, me kujtesën tënde. Liria jetohej në jetën kombëtare, kur flamuri ynë valon pa ndalim, kur historia jonë shkruhet me zërin tonë, kur vendimet për të ardhmen merren nga vetë qytetarët e këtij vendi. Liria kërkon nderimin e kujtesës, kërkon përgjegjësi. Kërkon që të mos harrojmë kurrë çmimin e saj. Sepse dikush dikur nuk e jetoj dot lirinë, që ne sot ta jetojmë. Mujë Krasniqi, Ali Krasniqi dhe Beqir Gashi nuk i kënduan vetëm lirisë, ata u bënë pjesë e saj.

Çabiqi dha tre dëshmorë, komandantin Mujë Krasniqin dhe të vëllain e Mujës, Ali Krasniqin, si dhe Muhamet Gashin, Sot ky fshat është ringritur si feniksi. Liria është dashuria që ndajmë si copën e bukës. Është kënga që nuk shuhet kurrë. Le të festojmë së bashku, me zemër, me këngë, me shpresë.

AKV" Jehona e Dukagjinit", të Klinës, u paraqit me një program të pasur artistik.



FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË KLINËS, PROF. DR. ZENUN ELEZAJ, NË FESTIVALIN FOLKLORIK MBARËKOMBËTAR "I KËNDOJMË LIRISË"



E nderuara familje Krasniqi, mixha Halil, baba i dy heronjve të kombit, Mujë dhe Ali Krasniqi, i nderuar ish kryeministër i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, i nderuar Xhavit Jashari, familjarë të dëshmorëve, heronjve, martirëve, invalidë, veteranë dhe përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, pjesëtarë të Ushtrisë e Policisë së Kosovës, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës të nivelit lokal e qendror, miq, artistë, dashamirë të artit dhe të kulturës nga të gjitha trojet shqiptare. Të nderuar të pranishëm,

Mirë se keni ardhur në Çabiqin heroik, në vendlindjen e Komandant Kapuçit, për ta hapur edicionin e 24-të të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë".

Si çdo vit, ky festival nis pikërisht këtu, në këtë vend që lindi dhe rriti një nga figurat më emblematike të luftës sonë çlirimtare. Kjo tokë ka lindur burra që i dolën zot atdheut në ditët më të vështira, burra që lirinë e Kosovës e vunë mbi jetën e tyre dhe që me sakrificën e tyre shkruan faqet më të ndritura

të historisë sonë kombëtare.

Sot nuk jemi mbledhur vetëm për të hapur një festival. Jemi mbledhur për të nderuar të kaluarën tonë, për të kujtuar dëshmorët e kombit dhe për të ruajtur amanetin e tyre. Festivali "I Këndojmë Lirisë" lindi nga ideja për ta mbajtur të gjallë kujtimin e luftës sonë çlirimtare dhe për ta përjetësuar veprën e Komandant Mujë Krasniqit dhe të gjithë atyre që sakrifkuan jetën për lirinë që ne sot gëzojmë.

Festivali "I Këndojmë Lirisë" është festival i kujtesës sonë kombëtare, i vlerave kombëtare dhe i traditave tona. Njëjtë sikur Muja që i këndonte heronjve dhe luftëtarëve për liri, edhe sot këtu e në tri netë në sheshin Mujë Krasniqi në Klinë, rapsodët me këngë, çifteli e sharki do t'i këndojnë Mujës, Alisë, dëshmorëve e heronjve të kombit dhe luftës së lavdishme të UÇK.

Këtu nuk këndohet vetëm kënga folklorike. Këtu këndohet historia jonë, këndohet për trimërinë, sakrificën dhe dashurinë ndaj atdheut. Çdo varg, çdo tingull çiftelie e sharkie, çdo valle dhe çdo kostum popullor përfaqëson një pjesë të mozaikut të madh të identitetit shqiptar.

Pikërisht për këtë arsye, Festivali "I Këndojmë Lirisë" ka arritur të ruaj dhe të përcjellë brez pas brezi trashëgiminë tonë kulturore. Ai ka bashkuar artistë e krijues nga të gjitha trojet shqiptare, duke dëshmuar se kultura jonë është një dhe se vlerat tona kombëtare na bashkojnë. Gjatë këtyre ditëve, festivali ynë, i cili për nga përmasat folklorike është shndërruar në një epike kombëtare, do t'i kujtojë dhe nderojë të rënët dhe të gjallët, sakrificën dhe plagët e tyre për tokën tonë të shtrenjtë. Nëpërmjet këngës dhe artit do të përcjellim te brezat e rinj mesazhin se liria nuk ishte dhuratë, burim i një sakrifice të madhe kombëtare.

Komuna e Klinës ndihet krenare që është shtëpia e këtij festivali, që përmes këtij manifestimi ruajmë jo vetëm kujtimin për Komandant Mujë Krasniqin dhe bashkëluftëtarët e tij, por edhe thesarin e pasur të kulturës sonë kombëtare. Për tri ditë me radhë, Klina do të jetë kryeqendra e folklorit shqiptar. Këtu do të mblidhen zërat më të mirë të këngës burimore, grupet artistike, valltarët e rapsodët që me talentin dhe përkushtimin e tyre i japin jetë këtij festivali.

Festivali "I Këndojmë Lirisë" ka edhe karakter garues. Në kuadër të tij ndahen 15 çmime, ku çmimi kryesor mban emrin e heroit Mujë Krasniqi. Për tri ditë me radhë, juria profesionale do t'i përcjellë me vëmendje të gjithë pjesëmarrësit dhe do të bëjë vlerësimin e tyre profesional, duke kontribuar në ruajtjen e cilësisë dhe prestigjit që ky festival ka ndërtuar ndër vite.

Në emër të Komunës së Klinës, falënderoj artistët, familjen Krasniqi, qytetarët e Çabiqit dhe të gjithë ata që ndër vite e kanë mbështetur këtë festival, duke e shndërruar atë në një nga manifestimet më të rëndësishme kulturore e patriotike në Kosovë dhe jo vetëm.

Jetë të gjatë festivalit dhe mbarësi juve! Lavdi jetës dhe veprës së Komandant Mujë Krasniqit dhe të gjithë të rënëve për çlirimin e Kosovës! Mirë u takofshim në edicionin e radhës!

Nata e parë konkurruese në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë"-2026

KËNGË E VALLE NGA TREVAT E KOSOVËS E TË SHQIPËRISË

Enver MALOKU, Sadri HAXHAJ, Bedri MORINA

Në Sheshin "Mujë Krasniqi" në Klinë, mbrëmë në natën e parë konkurruese në Festivalin Folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë", jehoi kënga dhe vallja folklorike. Aty pranë shtatores së Komandantit Mujë Krasniqi-Kapuçit, në binën e ngritur enkas për këtë ngjarje folklorike, në skenë u paraqitën këngëtarë, valltarë e instrumentistë nga Kosova dhe Shqipëria.. Edicionin e 24-të e hapi i pari Komunës së Klinës, kryetari Prof.Dr.Zenun Elezaj, i cili në fjalën përshëndetëse u dëshiroi mirëseardhje e suksese të gjithë festivalistëve që marrin pjesë në këtë manifestim folklorik.

Në skenë, jashtë konkurrencës u ngjitën këngëtarët dhe valltarët e AKV "Jehona e Dukagjinit", me një program të larmishëm e të pasur me këngë e valle të trojeve shqiptare. Festivali Folklorik mbahet nënë përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës, Prof.Dr.Zenun Elezaj. Para nisjes së konkurrimit për të pranishmit u shfaq një video incizim me pamje të luftës dhe të këngëve të Mujë Krasniqit, me regji të Alban Gashit e me muzikë të zgjedhur nga Arjon Gashi. Moderatore e festivalit është Besiana Mehmedi.

Në natën e parë konkurruese, të parët që u paraqitën para publikut, poashtu jashtë konkurrencës ishin rapsodët nga Deçani Mustafë Rama e Gazmend Avdyli me tekst të fuqishëm e interpretim të jashtëzakonshëm për daljen publike të UÇK-së.

SHKA "Katarina Josipi" nga Zymi e nisi konkurrimin, kryesisht me valle autoktone të Hasit, me një koreografi të pëlqyer. Ne skenë pastaj u ngjitën anëtarët e SHKA "Dedë Gjo Luli" nga Tuzi, fillimisht me këngë për Mujë Krasniqin dhe me vallet karakteristike të kësaj ane, si përherë me gjubletën e njohur shqiptare. Me këngë u paraqiten edhe rapsodët nga Mleqani, Egzon dhe Elvis Kryeziu. Ansambli "Teuta" nga Durrësi para publikut u paraqitën me disa këngë e valle të Shqipërisë mesme. Rapsodi Lutfi Istogu, këndoi për Bekim Berishen-Abea. Ndonëse, ishin jashtë konkurrencës valltarët e këngëtarët e AKV" Shotë Galica", ndonëse të rinj ishin profesionistë të vërtetë. SHKA "Jehona" e Suharekës, ishte një grup simpatike, kryesisht me valle, sidomos me ato të burrave. Me një program të larmishëm u paraqit edhe SHKA "Hajvalia" nga Prishtina. Natën e parë e mbylli shoqëria nga Istogu. Interesimi për ta përcjellë festivalin nga qytetarët e Klinës dhe më gjerë ishte i madh.



Fadil Gashi, ish pjesëtar i UÇK-së rrëfen për luftën, Mujën dhe festivalin

I BASHKOI LUFTA, LIRIA DHE KËNGA

Enver MALOKU



Fadil Gashi, aktualisht nënkryetar i Komunës së Klinës, ish pjesëtar i UÇK-së që nga themelimi i saj, është pjesë e organizimit të sivjetmë të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtarë "I Këndojmë Lirisë", tashmë tradicional që mbahet më 6, 7 e 8 qershor. Gashi tregon për luftën e lavdishme të UÇK-së, për trimërinë e Komandantit të shquar të UÇK-s, Mujë Krasniqit- Kapuçit, sakrificën e ushtarëve, fitoret, armatimin, lavdinë, krenarinë e kësaj periudhe të historisë si dhe për Festivalin Folklorik Mbarëkombëtarë "I Këndojmë Lirisë". Për luftën kur flet ka emocione, kur kujton dhimbjen, krenarin, për pushkën e këngën e cila ishte pjesë e luftës. Për festivalin, thotë se që nga ideja për organizimin e tij e deri të institucionalizimi i tij tregon gjithë

përkushtimin për ta lartësuar këtë manifestim folklorik gjithëkombëtar në nivelet më të larta. "Komuna e ka për obligim që t'i shërbej festivalit, jo vetëm financiarisht me krejt logjistikën deri në përfundim të tij sepse është festival mbarëkombëtarë, ndaj edhe kërkon angazhim të të gjithëve. Ky festival ka vlerën e madhe, me të cilin nderojmë figurën e Komandant Mujës. Klina për tri ditë me grupet, ansamblet artistike, instrumentistët nga të gjitha trojet shqiptare merr një gjallëri të veçantë", shprehet Gashi. Kur flet për luftën, kontaktet me Mujën, bashkëluftëtarët, Gashi tregon edhe momente të pa njohura deri tash. "Është hera e parë që e them publikisht se me Mujën jam njohur edhe para lufte, kur ishte burgosur bashkë me vëllain tim, Sadikun, që tejkalojnë njohjet në rrethana të tjera Muja bashkoi periudhat, edhe tash na bashkon Shtatorja në shesh, Kulla muze në Çabiq, që i tërë heroizmi i tij nuk mund të përfshihet vetëm në një shtatore. Bashkëpunimin e kemi pas në luftë vazhdimisht, duke përfshirë edhe bllokimin dhe vendosjen e barrikadave në Dollc. Pastaj të gjitha rrugët për furnizim me armatim nga Shqipëria kalonin kah na. Rënia e tij në Pashtrik bashkë me luftëtarët ka qenë e rëndë, jo vetëm si lajm por edhe si humbje e pa kompensueshme. Luftën e kemi vazhduar sipas amanetit të tij deri në çlirimin e vendit", tregon Gashi për ditët e luftës, dhimbjes e krenarisë, duke shtuar se edhe kënga gjithëherë na ka ndihmuar. Sot festivali ka edhe simbolikën e pushkës dhe të këngës. Vet kriteri garues i festivalit dhe zhanreve që iu përmbahet e lidh pushkën dhe këngën. "Edhe pas aksioneve e betejave gjenim kohë për të kënduar. I kishim veglat muzikore, çifteli e sharki, madje gjatë luftës janë organizuar dy martesë. Jam me fat që ishia pjesë e luftës, e historisë, sa të dhimbshme por edhe krenare e të lavdishme edhe për lirinë e fituar me gjak e mund. Fyerjet që i bëhen aty këtu janë të ulëta e të pa pranueshme në secilin aspekt. Koncepti i një pjesëtari të UÇK-së është pjesë e historisë dhe lavdisë, që do të kujtohen brez pas brezi.

Besiana Mehmedi, moderatore e festivalit "I Këndojmë Lirisë"

TË GJITHË SË BASHKU BËJMË BASHKIMIN E TROJEVE PËRMES KËNGËS E VALLES

Moderatore e festivalit të sivjetmë është Besiana Mehmedi, profesoreshë në Universitetin Tetovës. Ajo me një elekuencë të jashtëzakonshme dhe me një fjalor të pasur për evenimente të tilla, i jep peshë festivalit. Ajo për gazetën "Lyra", tha: "Të jesh pjesë e festivalit "I Këndojmë Lirisë", është nder e privilegj për çdo artist. Të gjithë ne kemi përjetuar kohëra dramatike në Kosovën e okupuar. I takoj gjeneratës që kam kryer shkollimin në shtëpi-shkolla. Kam përjetuar 12 ditë bombardime. Kujtoj që babai im Qani Mehmedi, i cili identifikohet si gazetar i luftës më fliste vazhdimisht për trimërinë e Mujë Krasniqit dhe gjithë trimat e UÇK-së, andaj lirinë që gëzojmë sot është meritë e sakrificës së atyre që falën më të shtrenjtën-jetën e tyre. Ta moderosh Festivalin "I Këndojmë Lirisë" është realizim i thënies së Mujë Krasniqit-komandant Kapuçit "Mos shikoni plagët e mia, por shikoni ku i ka kufijtë Shqipëria". Të gjithë së bashku bëjmë bashkimin e trojeve pa kufi nga jugu në veri përmes këngës e valles, që aq shumë i deshi Komandant Mujë Krasniqi, u shpreh Mehmedi.



Nata e dytë konkurruese në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë"

KËNGA DHE VALLJA PUSHTUAN SHESHIN "MUJË KRASNIQI"

Enver MALOKU, Sadri HAXHAJ, Bedri MORINA

KËNGA DHE VALLJA PUSHTUAN SHESHIN
"MUJË KRASNIQI"

Edhe nata e dytë konkurruese kaloi në shenjë të këngëve dhe valleve nga trojet etnike. Vallet ishin pikat më kulminante që dominuan natën e dytë, si me interpretim, po ashtu edhe me koloritin e veshjeve. Ndërkaq edhe sonte iu këndua trimave, heronjve, Mujë Krasniqi, Beqir Gashit e të tjerëve. E para që u paraqit në skenë ishte AKV "Ardhmërie" nga Gjakova, të cilët përformuan me dy këngë, Dasma dhe Moj Shqipni mos thuj marove dhe me një valle me motive patriotike. AKV "Ilirida" nga Shtimja para spektarorëve të shumtë u veçua për dy valle, njëra vallja e çikave dhe një valle tjetër, që binin në sy veshjet dhe interpretimi i mirë. Nga ky ansambël u dallua sidomos kënga "Lulëzoi fusha, lulëzoi mali", kënduar nga rapsodi Ilir Krasniqi, që mori duartrokitje të gjata për mënyrën dhe zërin e interpretimit. Rapsodi Emin Racaj, nga diaspora u paraqit me këngën "Kreshtat e Kosovës", që u mirëprit nga të pranishmit. AKV "Zahir Pajaziti", u paraqit me këngë e valle nga trevat e Llapit. Ndërkaq, ajo që e dalloj ketë ansambël ishte vallja e luajtur jashtë zakonisht mirë "Malli për Nexhmien". Vallëtarët e këtij grupi na përkujtuan të madhën Nexhmije Pagarusha. AKV "Selman Kadria", si gjithnjë besnike ndaj traditës së Podgurit si me këngë poashtu edhe me valle. Nga vlerat që sollën në skenë, ata u paraqitën edhe me tri këngë, "Pyt Kosova për një çikë", "Lind Kosova gjithmonë UÇK", pastaj vëllëzerit Sadikaj kënduan një këngë kushtuar heroniës Shote Galica. Ndërkaq përformuan edhe rapsodët: Nazmi Hajdari dhe Sylë e Avdyll Krasniqi, të cilët kënduan këngë kushtuar heronjve të kombit dhe motive nga rapsodia shqiptare. Në natën e dytë në skenë u prezantuan edhe Ansambli Autokton "Rugova", të cilët si zakonisht u paraqitën me valle e këngë me motive nga Rugova dhe që u duartrokitën nga masa e gjerë. Pastaj në skenë përformuan edhe AKV "Kastriotët" nga Ferizaji, të cilët u paraqitën me këngë e valle, e bënë edhe më imponante atmosferën e natës së dytë të Festivalit "I Këndojmë Lirisë".

E drejta e autorësisë mbrohet me ligj!



Drejtori i Festivalit

KLINA IDENTIFIKOHET ME FESTIVALIN PËR VLERAT, ARTISTIKE E TRASHËGIMORE

Bedri MORINA



1. ÇFARË VLERASH PREZANTOHEN NË FESTIVALIN FOLKLORIK MBARËKOMBËTARË "I KËNDOJMË LIRISË"?

Në festival prezantohen dhe promovohen vlera kombëtare dhe kulturore, si: liria dhe atdhe dashuria, ruajtja e traditave folklorike shqiptare përmes këngëve dhe valleve që i kushtohet dëshmorëve dhe veçanërisht nderimi për komandantin Mujë Krasniqi-Kapuçi, ku mbahet festivali për nderë dhe në ditëlindjen e tij.

Prandaj ky festival nuk është vetëm një aktivitet artistik, por edhe një manifestim që ruan dhe përcjellë vlerat e lirisë, kulturës, historisë dhe identitetit kombëtarë shqiptarë.

2. ÇFARË ËSHTË PJESËMARRJA E FESTIVALISTËVE.?

Në festival marrin pjesë nga të gjitha trevat mbarëkombëtare dhe diaspora, ansamble, grupe dhe rapsod folklorikë të cilat i ka përzgjedhur drejtorja artistike e festivalit, ku për tri netë me 6,7,8 Qershor bëhet defilimi në rrugët e qytetit dhe garimi i tyre në skenën madhështore të festivalit, ku në fund ndahen dhe çmimet ku çmimi kryesor është ÇMIMI "Mujë Krasniqi".

3. SI I VLERËSONI FESTIVALET E DERI TANISHËM DHE CILAT JANË ARRITJET E SHËNUARA NGA FESTIVALINË FESTIVAL?

Festivalet e deri tanishme, i vlerësoj si një aktivitet me të rëndësishëm kulturorë dhe kombëtarë në qytetin e Klinës, Kosovë dhe më gjerë. Ku nga viti në vit ka pasur përmirësim i cilësisë artistike që nga grupet pjesëmarrëse, skena, pjesëmarrja e audiencës.

4. SIVJET A KA NDONJË RISI QË MUND TË VEÇONINË FESTIVAL?

Risi është çdo vit , pjesëmarrja e ndonjë grupi të ri si dhe po shkojmë me vitin e dytë me radhë me skenën Led - Ekran me teknologjinë e fundit Led - Ekran, ku do të lëshohet video e intervistës së Mujë Krasniqi.

5. SI JANË ZHVILLUAR PËRGATITJET PËR FESTIVALIN E SIVJETMË?

Përgatitjet kanë filluar në muajin Mars duke i iniciuar procedurat tenderuese për mbarëvajtjen e festivalit, siç janë: bina, zërimi, akomodimi, ushqimi, tendat dhe karriget, krani dhe sigurimi. Drejtorja ka marrë detyrën nga muaji Prill për të përzgjedhur ansamblet, grupet dhe rapsodët folklorik për tri netët e festivalit. Janë bërë të gjitha përgatitjet për vendosjen e panove dhe flamujve në fshatin Çabiq ku me 6 Qershor bëhet hapja solemne zyrtare në Kullën e Mujë Krasniqit në ditëlindjen e tij, dhe vendosja e flamujve në qytetin e Klinës të gjitha përgatitjet janë me kohë.

6. ÇFARË DO TË THOTË PËR KLINËN ORGANIZIMI I NJË FESTIVALI FOLKLORIK MBARËKOMBËTARË?

Në këtë vit është edicioni i 24-të me radhë i cili mbahet nën përkujdesjen e Komunës së Klinës-Kryetarit të komunës Prof. Dr. Zenun Elezaj, dhe është krijuar një traditë e organizimit të festivalit ku angazhohen të gjitha grupet punuese të cilët i falënderojë për punën e tyre.



Drejtori i Kulturës në Klinë, Lorenc Marku

MUJA ËSHTË SIMBOL I FORCËS, I QËNDRESËS DHE I SHPIRTIT TË PATHYESHËM SHQIPTAR

Sadri HAXHAJ



Përgatitjet për këtë festival nuk kanë qenë vetëm teknike apo organizative, por mbi të gjitha shpirtërore. Komuna e Klinës, konkretisht Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, përmes një angazhimi të përbashkët, ka punuar me përkushtim që çdo detaj të pasqyrojë dinjitetin dhe vlerat që përfaqëson ky festival e që është Ditëlindja e Heroit tonë Mujë Krasniqi. Nga skena e deri te mikpritja e mysafirëve, çdo gjë është bërë me dashurinë për kulturën dhe respektin për traditën që e mbajmë gjallë tash e 24 vite.

Ky festival nuk është vetëm një ngjarje kulturore, por një ndjenjë që na bashkon të gjithëve. Organizimi i këtij viti ishte një dëshmi se kur punohet me zemër, rezultati është i jashtëzakonshëm. Atmosfera, emocionet dhe energjia që u ndje gjatë gjithë festivalit tregojnë se "I Këndojmë Lirisë" vazhdon të jetojë

në shpirtin e qytetarëve dhe artistëve. Për mua personalisht, kjo ka qenë një përvojë që do ta mbaj gjatë në zemër. Përgjegjësia ishte e madhe, por edhe krenaria po aq. Çdo moment i këtij organizimi ka qenë i mbushur me emocione, sfida dhe kënaqësi të veçantë. Të shohësh njerëzit të bashkuar rreth vlerave të kulturës dhe lirisë është ndjenja më e bukur që mund ta përjetojë një drejtues në këtë fushë. Muja është simbol i forcës, i qëndresës dhe i shpirtit të pathyeshëm shqiptar. Ai nuk është vetëm një figurë e së kaluarës, por një frymëzim që jeton edhe sot në secilin prej nesh. Ky festival është një kujtesë e gjallë e asaj që kemi qenë dhe e asaj që duhet të mbetemi. "I Këndojmë Lirisë" është më shumë se një festival - është zëri i historisë sonë dhe i dashurisë për lirinë që nuk shuhet kurrë.

PANAIR I PRODUKTEVE VENDORE DHE ARTIZANALE

Sadri HAXHAJ

Në Klinë edhe këtë vit për të nëntën herë më radhë është bërë hapja e panairit më produktet vendore dhe artizanale nga prodhuesit vendor nga Klina dhe më gjerë.

Hapjen e kësaj ngjarjeje e ka bërë kryetari i komunës së Klinës, Zenun Elezaj bashkë me drejtoreshën komunale të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Iliriana Toplanaj si dhe drejtori i Kulturës, Lorenc Marku.

Drejtoresha, Toplanaj tha se këtë vit po marrin pjesë 20 kompani të ndryshme nga e mbarë Kosova, derisa u shpreh e kënaqur më interesimin e prodhuesve vendorë që të marrin pjesë në këtë panair. Pjesëmarrësit në panair kishin ekspozuar kryesisht prodhime ushqimore duke përfshirë, mjaltë, djathra, produkte të mishit, pastaj, pije nga prodhimet e rrushit dhe të kumbullave e deri të produktet artizanale si pjesë e traditës sonë kombëtare.

Njëri nga pjesëmarrësit e këtij panairi Burim Dushi u shpreh i kënaqur më këtë pjesëmarrje sepse sipas tij organizimet e tilla po kontribuojnë në promovimin e prodhimeve e sidomos atyre vendore.



Shaqir Hasi, drejtor i AKV "Shotë Galica" nga Drenasi.

FESTIVAL I TIPAREVE ETNIKE SHQIPTARE

Sadri HAXHAJ



Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Shotë Galica" nga Drenasi, për të shumtën herë merr pjesë në Festivalin "I Këndojmë Lirisë", që mbahet në Klinë.

Drejtori i këtij ansambli, Shaqir Hasi ka rrëfyer për revistën Lyra për historikun, të arriturat e deritanishme si dhe kushtet aktuale me të cilat ballafaqohet ky ansambël.

AKV "Shotë Galica" është themeluar më 14 prill të vitit 1969 dhe aktualisht numëron mbi 50 anëtarë. Hasi, tregon se "Shotë Galica", përbëhet prej dy grupeve, ku bëjnë pjesë grupi i të rriturve dhe të rinjëve. Ndërkohë, ky ansambel, edhe pse në kushte të vështira financiare dhe infrastrukturore, ka arritur që të marr pjesë në festivalet kombëtare dhe ndërkombetare duke i sjell Drenasit një mori çmimesh.

Drejtori Hasi, ka sqaruar se AKV "Shotë Galica" përveç në festivalet mbarëkombëtare, si fitues i shumëfishtë, ky ansambel ka marrë pjesë edhe në festivalet ndërkombetare, si në Turqi, Austri, Gjermani, Belgjikë dhe Zvicër.

Ndërkohë që edhe në festivalin "I Këndojmë Lirisë", ky ansambel ka fituar disa herë çmimin kryesor "Mujë Krasniqi" dhe poashtu është shpërblyer edhe me çmime tjera të këtij festivali.

Hasi ka fjalë të mira edhe për festivalet e Klinës dhe thotë se Klinja ishte ndër komunat e para të pas luftës themeloi festivalin folklorik "I Këndojmë Lirisë", dedikuar Komandant Mujë Krasniqit - Kapuçit, i cili ra heroikisht sëbashku me Beqir Gashin e luftetarë të tjerë në Pashtrikun heroik.

Në këtë festival, paraqiten tiparet etnike të kulturës shqiptare të Kosovës, por edhe të trevave tjera shqiptare, në të cilat interpretohet një mozaik, këngësh, melodish epike e lirike ku lartësohet heroizmi i dëshmorëve të lirisë.

Prezantimi i materialeve artistike në festivalin "I Këndojmë Lirisë" ka dëshmuar se populli dhe treva e Klinës ka ruajtur të gjitha elementet më të lashta të kësaj pasurie kombetare.

Ajo që ka mbizotëruar në festivalin e Klinës ndër vite, ishte karakteri burimor i lëndës folklorike, origjinale me vlera të papërsëritshme artistike të të gjitha trevave shqiptare.

Duke marrë pjesë në shumë festival, qoftë edhe si anëtar jurie dhe pjesëmarrës me projektet e mija nga fusha e artit kam përshtypjet më të mira dhe organizatorët i inkurajoj të vazhdojnë punën në mënyrë që ky festival të pasurohet me vlerat më të çmuara të folklorit tonë burimor nga mbarë gjeografia shqiptare.



NAIM S. KRASNIQI, NJË JETË U KËNDOI ATDHETARËVE

Enver MALOKU



Naim Salih Krasniqi, është ndër rapsodët më të njohur në Kosovë dhe në trevat tjera shqiptare. Këngën e ka trashëguar nga babai i tij Salih Bajrami, legjendë e këngës folklorike. Naimi flet për të kaluarën, për këngën, për dasmat e gazmendet e ndryshme në odat e kullat shqiptare. Rrugëtimi i tij me këngën folklorike, me çiftelinë e sharkinë është shumë i hershëm. Ai kujton edhe kur nisi të këndoje e të mishërohet me te, e cila vazhdon ti mbetet në shpirt. “Këngën e kam filluar diku rreth moshës pesë vjeçare, kuptohet bashkë me babain tim Salih Bajram, i cili ishte inspirimi, frymëzimi dhe nxitësi më i madh, me të cilin qysh si fëmijë i vogël e kam filluar rrugëtimin tim prej rapsodi”, kujton me emocion nisjen e tij për të kënduar dhe për tu bërë i adhurueshëm për dashamirët e folklorit shqiptar. Ai, pastaj tregon për këngët e preferuara, këngët të cilat i ka kënduar, duke veçuar këngët patriotike, por bashkë me të tjerët ka kënduar edhe këngë folklorike të zhanreve të ndryshme, si këngë arshikije, krahina, siç u kanë thënë pleqtë, këngë epike, lirike, e të tjera. “Mirëpo kur u këndohet trimave tanë, kuptohet se është një emocion i veçantë, sepse ata dhanë çdo gjë për lirinë e vendit. Ndërkaq, në festivale kemi kënduar për publikun dhe adhuruesit tanë të cilët çdo herë na ka përkrahur dhe nderuar”, shprehet Naimi, duke përkujtuar karrierën e tij të pasur të këngës folklorike. Naimi tregon me krenari kur ka kënduar këngë patriotike në kohërat e rënda, por duke mos ua heq asnjë pikë e pres tekstin të këngëve, të cilat lartësoni figurat e njohura të historisë së kombit, dhe luftërat e trimëritë e tyre kundër pushtuesve osmanë e serbë. Përkundër terrorit që ushtrohej edhe në muzikë atë s'e kanë ndalë kurrë duke frymëzuar gjenerata e gjenerata për ta larguar pushtuesin nga atdheu i ynë. Ai kujton këngët për Oso Kukën, Isa Boletinin, Sefë Kosharën, Ahmet

Delinë, Azem Bejtën, Adem Jasharin, Mujë Krasniqin, e heronjtë tjerë të UÇK-së. Në Festivalin Folklorik gjithëkombëtar “I Këndojmë Lirisë”, që mbahet, më 6, 7 e 8 qershor për çdo vit në Klinë, Naimi thotë se merr pjesë që nga themelimi tij par më shumë se dy dekadave. “Në festivalin “I Këndojmë Lirisë”, që i kushtohet Mujë Krasniqit – Komandant Kapuçit, kemi marrë pjesë që nga fillimi për shumë vite me radhë. Pjesëmarrja në këtë festival për mua është nder i madh, sepse i këndohet një rapsodi luftëtar. Përveç që ishte luftëtar, Mujë Krasniqin e kam njohur si fëmijë, ngase sipas të dhënave jemi degë të një trungu. Festivali në fjalë është një nga më të qëlluarit, sepse tashmë është edhe festival gjithëkombëtar që përcjell vlera historike dhe krenarie. Në këtë festival kemi marrë pjesë shumë herë, për vite me radhë, dhe jemi dekoruar me çmime të ndryshme, për të cilat jemi shumë falënderues”, tregon ai duke folur për vlerat e këtij festivali të përmasave gjithëkombëtare. Nuk mund të tejkalohej edhe pyetja se sa po kultivohet kënga folklorike në familjen e ti të gjerë, dhe kush po e vazhdon këtë traditë sa folklorike edhe e karakterit historik, për ta përcjellë këngën e mirëfilltë folklorike brez pas brezi. “Tradita e këngës folklorike shqiptare në familjen tonë po vazhdon edhe në ditët e sotme. Përveç meje, me karrierë 50-vjeçare, këngët e Salih Bajramit tashmë po i vazhdon edhe biri im, Salih Krasniqi i riu, i cili i këndon këto këngë me shumë dashuri e krenari”, theksoi, Naim S. Krasniqi, i cili një jetë të tërë e kaloi me këngën folklorike. Dueti legjendar Salih dhe Feriz Krasniqi, në Langolen të Anglisë, në vitin 1966 e kishte zënë vendin e parë në interpretimin e këngës folklorike “Lulëzoi fusha, lulëzoi mali”.

Portret krijuesi

**SHTATË PYETJE PËR IDRIZ BERISHËN-XHIXHI,
PIKTOR E POET**

Enver MALOKU



1. Kush është Idriz Berisha - Xhixhi, piktor akademik, poet, shkrimta
2. Si është ta kalosh një jetë, me pikturë, bojra, brusha, pano etj.
3. Aty ku punon për ditë në atelenë
4. Je i njohur për skenat e përgatitura për Festivalin "I Këndojmë Lirisë. Çfarë ndjenje është?
5. Një mural pas luftës i bërë nga ti në një nivel të lartë artistik, u mbulua. E ke pengë?
6. Sa e ngrit një festival skena e përgatitur profesionalisht. Kur punoje a e kishe para sysh Mujën e të tjerët por edhe artistët që ngjiten në skenë?
7. Çfarë bëjnë Berisha të dielën, në ditën pushimit në ditën e shtatë të javës_

U lind në Dobërdol të Klinës (1953), shkollimin fillor e ka kryer në Ujmirë, të mesmen, atë të artit në Pejë (1972) për të vazhduar studimet në Akademinë e Arteve dhe magistraturën po aty. Nga vitet e 70-ta pashkëputshëm merret me krijimtari në pikturë, vizatim, grafike, ilustrime librash, kopertinash, gazetash e skenografi festivalesh e dramash, për mbi 50 vjet. Është edhe veteran arsimit dhe i UÇK-së si kontribuues në punët profesionale duke

punuar targarat për automjete për nevoja të ushtrisë, kamuflimin e uniformave ushtarake, mbishkrimeve e punëve tjera për nevojat e luftës. Biografia e tij është e pasur me aktivitete si pedagog shumë-vjeçar, piktor Akademik i asociuar në shumë forume, pjesëmarrës e fitues i dhjetëra Çmimeve Kombëtare e Ndërkombëtare në Kosovë, Shqipëri e shumë shtete të EU.... Rreth 40 ekspozita personale në Klinë, Skënderaj, Pejë, Gjakovë, Prishtinë, Ulqin, Gjirokastër, Tiranë, Lezhë. Në galeri Ndërkombëtare: në Zvicër, Francë, Gjermani, Romë, Maqedoni, Mali i Zi - Rozhajë etj. Si dhe përmes SHAFK në ekspozita e simpoziume të shumta nëpër shumë galeri Arti në Mitrovicë (Çmimi Kadri Kadriu), Prishtinë, Çmimi special në Global Art, Pejë, Çmimi për pikturë, Gjilan, Çmimi "FLAKA e Janarit", Ferizaj, Çmimi "Gursel Sylejmani për pikturë", e dhjeta nëpër galeri të ndryshme shqiptare e të jashtme. Është anëtar i rregullt dhe i dekoruar tre herë nga AA PEGASI Albania-Artist i Shquar....

Studiues të artit që shkruan e vlerëson artin e tij: Mustafa Ferizi, Prof. Dr. Hivzi Muharremi, Prof. Prend Buzhala, Mr. Haki Xhakli, Cazarini, Sejdi Berisha etj.

Edhe pse soldateska serbe ja dogji të gjitha veprat 30 vjeçare në pikturë, arriti ti kompensoj me të reja duke tejkaluar numrin.

Merret edhe me poezi. Katë botuara 6 përmbledhje me poezi e një në shtyp që sivjet pritet të dal.

Si anëtar i LSHK, kam çmimi: LSHK-BARDI e çmimi, Adem Demaçi për poezi dhe shumë çmime nga investimet letrare anë e kënd hapësirave shqiptare.

Është i përfshirë në Fjalorin Enciklopedik i Kosovës si piktor dhe në Leksikon Enciklopedik të Akademisë shqiptaro-amerikane. Një jetë kushtuar artit qenka tepër pak, sa ikën shpejt vitet e veç kujtimet e veprat mbesin. Krijuesi gjatë rrugës mëson shumëçka dhe e formëson vetin si person krijues.

Piktura dhe arti në përgjithësi të fisnikëron shpirtin, ta shton dashurinë ndaj jetës, natyrës, njerëzve e atdheut.

- Edhe pas pensionimit vazhdon të krijoj intensivisht në art galerinë time që familja ma dhuroj. Aty nga mëngjesi në mbrëmje. Rinohet duke mbajtur gjallë frymën artistike krijuese. Artgaleria në Dobërdol çdo ditë pret vizitorë, studiues, ekipe televizive, nxënës, studentë e të huaj por edhe porositës të pikturave.... Është bërë pikë kulturore për vizitorë. Kënaqësi e pa përshkruar!

- Nga paslufta, punoi DKRS dhe pos ekspozitave me krijues grup moshave të ndryshme, ishte edhe bashkëthemelues i Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", njëherë drejtor i Festivalit e 17 herë skenograf.

Kam pas punuar 17 Skenografi masive deri në 20m e të larta 5-6m. Të gjitha me koncept Folklorik dhe me motive nga trashëgimia kulturore e të luftës. Unë e njoha nga fëmijëria Mujë Krasniqin, ai shpirtin e kishte atdhetar po edhe artdashës. Vinte të studio ime, e donte pikturën e donte këngën dhe lirinë.

Njëherë erdhi për Festivali artisti Frrok Haxhia, kur e pa skenën me shtrengoj dorën e më tha: Epaskeni bërë Gjirokastër Klinën". Tash teknologjia ka përparuar. Bëhen skenografitë, më thjeshtë, më lehtë... me rëndësi që në Klinë të vazhdohet me këtë traditë festivalesh por kam një porosi për organizatorët; Mos na harroni, e na e vlerësoni punën që bëjmë.

Me vjen keq por ne që e themeluan dikur, kur tash vijmë në mbrëmjet e Festivalit, as karrige nuk na sigurohet....

- Sa punoja aty të "Jehona e Dukagjinit", pata pikturuar një mural tematik me Adem e Hamzë Jasharin e Mujën", i cili pat bërë bujë në Kosovë sepse Murali ishte me tematikë lufte të UÇK-së. Murali u zhduk bashkë me objektin e Qendrës kulturore.

- Skena e skenografia e Festivalit është pjesë vizuale qendrore e Festivalit, sfond dhe pamje që i shton bukurinë e valleve, këngëtareve e grupeve përformuese.

SHKA "DEDË GJO LULI"-TUZ, RUAN DHE KULTIVON TRASHËGIMINË KULTURORE DHE KOMBËTARE

Bedri MORINA

SHKA "Dedë Gjo Luli" e Tuzit, është sinonim dhe përfaqësues tipik i këngës" vallëve dhe trashëgimisë kulturore, jo vetëm e Tuzit, por edhe i shqiptarëve, të Ana Malit dhe trojeve tjera ku jetojnë shqiptarët në Mal të Zi. Ky ansambël ka një histori të njohur deri në ditët e sotme. SHKA "Hoti" nga Hoti u themelua në vjeshtën e vitit 1977 pikërisht në Hot të Malësisë së Madhe. Qëllimi kryesor i kësaj shoqate ishte është dhe do të jete ruajtja dhe kultivimi vlerave të trashëgimisë kulturore dhe kombëtare. "Me kalimin e kohës disa anëtarë të kësaj shoqate, më në krye me Gjokë Gojçajn dhe disa të tjerë vendosen që shoqatës t'ia ndërrojnë emrin nga shoqata në SHKA "Dedë Gjo Luli", emër të cilin e mban edhe sot me shumë krenari. Kjo shoqatë vazhdoi me të njëjtin qëllim për te ruajtur vlerat kulturore. SHKA "Dedë Gjo Luli" vazhdon te mbetet besnike e këngës folklorike, valleve veshjes dhe instrumenteve si: lahutës, fyellit, çiftelisë, valleve etj. Shoqata në fjalë është pjesëmarrëse e shumë aktiviteteve kulturore brenda dhe jashtë trevave të Malësisë. Kjo shoqatë mori pjesë ne shume festivale si, në atë të Rapshës, Lezhes, Vermoshit, Tiranës, Tropojes, Klinës, Drenicës, Pej, Deçan, në Strug dhe shumë vende te tjera te Kosovës dhe Shqipërisë. SHKA "Ded Gjo Luli" është fituese e shumë çmimeve, mirënjohjeve. Në bashkëpunim me TV "Boin" ka incizuar edhe disa filma si: "Dasma e Malësisë", "Çaste te përjetuese", "Burrat e Deçiqit" e shumë të tjera", thotë Drejtori Artistik i SHKA "Dedë Gjo Luli", Viktor Tusha.

LEONID SHLLAKU, I PASIONUAR PAS LAHUTËS

Bedri MORINA

Leonid Shllaku është lahutari më i ri në komunën e Klinës, por edhe më gjerë. Ai është rritur me lahutën, e ka edhe pasion madje edhe identifikohet me te. Për mua është nder dhe privilegj që me identifikojnë si lahutari më i ri ne Kosovë. "Me lahutë kam filluar qysh në moshë të re, diku rreth moshës 8 vjeçare. Mësimin e kam marrë nga gjyshi im i cili ka qenë lahtar i njohur. Është ndjenjë shumë e mirë sepse me lahutë këndohen këngë epike, historike ku në tel të lahutës ju kanë thurur lavde shumë trimave prandaj për mua është një ndjenjë e veçantë ku mundohem të këndoj në mënyre sa më origjinale. Unë kam marrë pjesë në shumë festivale, si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë vendit ku jam shpërblyer me çmime dhe mirënjohje", e fillon rrëfimin e tij Shllaku. Ai bënë thirrje që të rinjtë të kenë interesim më të madh për lahutën, sepse ë instrument i vjetër kombëtar. "Të rinjtë kanë shumë pak interesim për lahutën ku për ne është një zhgënjim por mundohem që ta përcjell në gjenerata te reja që të mos jete lahuta vetem si dekor i varur në mur por edhe të praktikohet - të luhet dhe të këndohet me te. Në Festivali folklorik "I Këndojmë Lirisë" lahuta nuk e ka vendin meritore që i takon, por shpresoj që në të ardhmen do të jete më e pranishme. Lahuta është e jona, ku vet forma e saj flet shumë. Është një ndër pasuritë më të mëdha që kemi. Jam i lumtur që tani është pjesë e UNESCO-s, ndërsa sa i përket shteteve fqinje e kanë ditur që lahuta ju përket shqiptarëve, por po e them një fjali popullore : "Sendi i huaj kurrë nuk bëhet i yti".



Besnik Brahimi Drejtor i AKV- "Ilirida" nga Shtimja

FESTIVALI I KLINËS, FESTIVAL I RUAJTJES SË TRASHËGIMISË SONË KULTURORE

Sadri HAXHAJ

Në festivalin folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë" për disa herë radhazi merr pjesë edhe AKV "Ilirida" nga Shtimja. Ky Ansambël përbëhet prej pesë seksioneve: solistë këngëtarë, orkestra, grupi i valleve dhe kori. Drejtori i këtij Ansambli Besnik Brahimi flet për revistën Lyra rreth këtij ansambli dhe për përshtypjet e tij për festivalin folklorik mbarëkombëtarë "I këndojmë Lirisë"



Sipas tij qëllimi kryesor i Ansambli "Ilirida", është të promovojë këngët dhe vallet tradicionale shqiptare, duke dhënë një hapësirë të merituar në skenat kombëtare dhe ndërkombëtare. Ansambli synon të jetë një urë-lidhëse mes brezave, duke inkurajuar të rinjtë të angazhohen në ruajtjen e traditave dhe të ndjejnë krenarinë për trashëgiminë e tyre kulturore.

Përmes performancave të ndryshme, ansambli po ofron një përvojë të pasur artistike, duke përfshirë këngë popullore, valle tradicionale dhe instrumente të ndryshme që përfaqësojnë kulturën shqiptare. Ne besojmë se arti është një mjet i fuqishëm për të bashkuar njerëzit dhe për të promovuar një ndjenjë të përbashkët identiteti.

Ansambli "Ilirida" për gjatë një viti organizon një sërë aktivitetesh, duke përfshirë koncerte festive, marrje pjesë në festivale mbarëkombëtare, si dhe organizimi i festivalit folklorik kombëtar "Folk Fest" në Shtime. Përmes këtyre aktivitetëve të rinjtë Shtimjan do të kenë mundësinë të mësojnë rreth traditave dhe të zhvillojnë

aftësitë e tyre artistike. Ne jemi të përkushtuar për të krijuar një ambient ku çdo anëtar mund të shprehë kreativitetin e tij dhe të kontribuojë në pasurimin e repertorit të ansambli.

Ansambli ynë aktualisht numëron 80 anëtarë ku përfshihen grupi parë i vallëtareve, grupi i të vegjëlve, orkestra ku numëron 9 instrumentistë, grupi i këngëtarëve/e.

Deri më tani ky Ansambel ka marrë pjesë në shumë festivale mbarëkombëtare duke u nisur në atë në Shkup, Burrel, Kaçanik, Klinë, Kamenicë, Hani i Elezit, Gjakovë, Opojë, Viti, Komoran, Gjonaj, Rahovec si dhe Festivale ndërkombëtare duke përfaqësuar Republikën e Kosovës në festivalin në Denizli - Turqi, "Kitka Istibanja" - Maqedoni dhe Saraj Fest Shkup, Maqedoni.

Kushtet që ka ansambli mund të them se janë tejet të kënaqshme, duke filluar nga infrastruktura ku ne gezojmë një shtëpi të kulturës me salla të provave, zyre, zhveshtoret, salla koncertale etj. Kjo bënë që ne si ansambel ta kemi më të lehtë të punojmë pikërisht falë këtyre kushteve. E për këtë ju jemi mirënjohës

institucioneve tona komunale të cilat po na perkrahen më gjitha mundësitë si: morale, materiale e infrastrukturë të mirë.

Po ashtu përveç komunës ansambli ka përkrahës edhe Ministrinë e Kulturës, cila po e mbështet një projekt, i cili vie për herë të parë në qytetin tonë e që është festivali folklorik "Folk Fest" në Shtime, ku çdo vit po mbledh ansamble nga mbarë trevat Shqiptare.

Ansambli "Ilirida" është fituese e mbi 40 çmimeve, ku përfshihen; dy vende të para, dy vende të dyta, një vend i tretë, e shumë fitues të çmimeve si: Orkestra më e mirë, valltarët më të mirë, solistja më e mirë, rapsodi më i mirë, këngëtarja më e mirë, dyshja më e mirë, Koreografia më e mirë, Instrumentisti më i mirë, çmimi i publikut etj.

Mendimi im është që festivali "I Këndojmë Lirisë" në Klinë është ndër festivale më të rëndësishme folklorike dhe patriotike në Kosovë, sidomos për ruajtjen e folklorit burimor, rapsodisë dhe kulturës kombëtare. Ka traditë të gjatë dhe mbahet çdo vit më 6, 7 dhe 8 qershor, në nderim të luftës dhe figurës së Mujë Krasniqit.

THESARET LABE, THESAR I POLIFONISË

Enver MALOKU

Grupi Polifonik "Thesaret Labe", Tiranë është një ndër grupet më të mira të polifonisë labe i cili ka rreth 10 vjet që është krijuar dhe ka një repertor me 150 këngë.

Ka marrë vlerime në shumë festivale nga juritë profesjoniste që nga çmimi i parë në Festivalin e Rapsodisë Shqiptare në Skënderaj çmim të dytë të tretë, çmim publik, çmime të tjera dhe pllakë mirnjohëse nga Diaspora Shqiptare në Amerikë.

Është grupi që është bërë pjesë e pa ndashme për pesë vite rresht në FF Gjithkombëtar "I Këndojmë Lirisë" në Klinë, të cilin e vlersojmë shumë, si një ndër festivale të mira që zhvillohet në Kosovë për mënyrën e organizimit dhe performancës artistike të artistëve pjesëmarrës në skenën e bollshme dhe funksionale që i plotson të gjithë parametrat artistikë.

Grupi ynë çdo vit paraqitet me krijimtari të re artistike duke ja kushtuar tekste kryesisht heronjve të Kosovës Adem Jasharit, Muj Krasniqit UÇK dhe gjithë martirëve të tjerë të Kosovës.

Paraqitja jonë skenike ka qënë çdo vit me nivel të lartë artistik, ku kemi marrë mbështetje të vazhdueshme nga publiku që na ka ndjekur me shumë interes dhe kemi vlersuar dy vite rrsht me çmim publik, si dhe për kostumografinë.

Edhe këtë vit do të jemi pjesëmarrës në këtë festival që është shumë i dashur për ne, duke u përgatitur serjozisht për veten tonë, por edhe për publikun që na ndjek dhe vleron.

Drejtuues Artistik i grupit Thesaret Labe Tiranë Viktor Aliu.



Edhe sivejt, drejtoria Artistike e Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", në përbërje, Halit Gashi, drejtor, Fatmir Berisha dhe Daut Gashi, anëtarë, kanë bërë përzgjedhjen e ansambleve, grupeve artistike, vallëtarëve rapsodëve e instrumentistëve që kanë marrë pjesë në festival, nga të gjitha trojet shqiptare.

Jahir Bashota bashkëkëngëtar i Komandant Mujë Krasniqit-Kapuçit

MUJË KRASNIQI NJERI ME SHPIRT ARTISTI E ZEMËR ATDHETARI

Sadri HAXHAJ



Festivali "I Këndojmë Lirisë" është një ndër ngjarjet më të rëndësishme kulturore e kombëtare, sepse ruan folklorin burimor dhe përcjell te brezat vlerat e lirisë dhe atdheadashurisë. Sa herë mbahet festivali, ringjallet vepra, kujtimi dhe heroizmi i Komandant Mujë Krasniqit, Aliut, Beqir Gashit dhe i gjithë të rënëve për lirinë e atdheut.

Mujë Krasniqin e kujtoj më shumë sesa një bashkëkëngëtar, sepse kemi qenë të lidhur shumë më tepër se veç përmes muzikës. Ai ishte njeri i jashtëzakonshëm, me shpirt artisti dhe zemër atdhetari. Këndonte me shumë emocion dhe dashuri për vendin, duke i dhënë këngës shpirt e ndjenjë të veçantë. Por ka qenë sfiduese për mua që kam qenë pjesë e shumë festave familjare e atdhetare me të, sepse ai kërkonte nga unë që të hapja diskutime nëpër tubime, oda, ahengje, dasma e festa, që të merrja pak a shumë impulsin e popullit se si qëndronte gatishmëria e tyre për një qëndresë luftarake kundër Serbisë. Kjo ka qenë sfidë, veçanërisht në organizimet për nder të 28 Nëntorit dhe në ahengjet e asaj kohe, ku kishte pjesëmarrës të natyrave të ndryshme, nga doktorë shkence deri te njerëz të papërshtatshëm e të dyshimtë, të cilët shpeshherë paraqisnin rrezik për ne që këndonim këngë patriotike në kohën e okupimit, kur frymëzonim brezat për liri dhe qëndresë. Përveç Mujë Krasniqit dhe Aliut, kam pasur bashkëpunim dhe lidhje të afërta edhe me Beqir Gashin, me të cilin kemi ndarë hallet,

shqetësimet dhe preokupimet e kohës. Kam qenë i afërt me ta dhe kam pasur kontakte të shumta dhe gjithmonë ruaj ndjenjën e krenarisë për qëndrimin, veprën dhe heroizmin e tyre.

Mujë Krasniqin e kam njohur në dy dimensione të veçanta që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën time: si bashkëkëngëtar dhe si luftëtar. Në të dy rastet ai shquhej për një karakter të fortë, për vendosmëri dhe për një shpirt të jashtëzakonshëm bashkues. Në këngë, ai ishte i sinqertë dhe i përkushtuar, duke e përcjellë me emocion frymën e popullit dhe të traditës sonë. Ndërsa në rrugën e luftës, ai u shndërrua në simbol të qëndresës dhe të sakrificës për liri. Disa nga momentet e kaluara pranë tij mbeten kujtime të paharruara, sepse përveç bashkëpunimit, aty shihej qartë edhe karakteri i tij njerëzor dhe atdhetar, i cili e bënte të veçantë në çdo rrethanë.

Atë e dallonte zëri i fuqishëm, interpretimi burimor dhe ndjenja e fortë që përcillte në çdo këngë patriotike e folklorike. Ishte i vendosur kur këndonte këngën, pavarësisht pasojave, sepse mund të burgoseshim.

Folklori ynë burimor vazhdon të jetë një thesar kombëtar, por ka nevojë për më shumë mbështetje dhe përkujdesje që të ruhet autenticiteti i tij. Interpretimi duhet të jetë më i harmonizuar me tekstin dhe intonacionin, sepse kur këndohet një tekst që pasqyron dhimbjen e humbjes së një heroi apo fëmije, duhet kënduar me dhimbje e jo me bërtitje, sikur të kishe fituar kur të kanë vrarë. Madhështia është kur interpretimi bëhet sipas natyrës tekstuale, përmes së cilës pasqyrohet vuajtja, dhimbja, trimëria dhe heroizmi. Festalet folklorike luajnë rol shumë të madh në ruajtjen e kulturës, traditës dhe identitetit kombëtar shqiptar, sepse kënga ka qenë gjithmonë ndër instrumentet kryesore në edukimin atdhetar shqiptar dhe një vlerë e madhe kombëtare.

Organizimi i festivalit është shumë i

rëndësishëm dhe i denjë për figurën e Komandant Mujë Krasniqit, sepse përmes tij nderohen lufta, liria dhe trashëgimia jonë kombëtare, e cila duhet të vazhdojë.

Këngët për dëshmorët sjellin krenari, emocione dhe mall për sakrificën e madhe të bërë për lirinë e Kosovës. Njëherazi, na rikujtojnë borxhin që kemi kundrejt sakrificës së tyre dhe vendit tonë, për një të ardhme më të ndritur në frymën e sublimës së dëshmorëve.

Ky festival është shumë i rëndësishëm, sepse i afron të rinjtë me historinë, kulturën dhe vlerat kombëtare shqiptare, me këngën, vallen dhe kulturën në tërësi. Por ende duhet bërë më shumë për mbështetjen e rapsodëve dhe ruajtjen e folklorit tonë burimor, sepse kjo vlerë ka nevojë më shumë se kurrë të çmohet dhe të lartësohet.

Artistët e rinj duhet ta duan dhe ta ruajnë këngën folklorike shqiptare, sepse ajo është pjesë e identitetit dhe historisë sonë kombëtare. Ta kenë parasysh tekstin, protagonistin, porosinë dhe interpretimin. Pra, interpretimi duhet të posedojë elemente të vetë dëshmorit për të cilin këndohet, e jo të bëhet interpretim personal, sepse kënga është dedikim për dikë, jo që interpretuesi të bëhet personazh kryesor me elemente jashtë kornizave të asaj që po interpretohet, kujtohet dhe nderohet.



AKV "Drenica" e Skenderajt katër herë fituese e Çmimit "Mujë Krasniqi"

"DRENICA", VLERË KOMBËTARE E HISTORIKE E FOLKLORIT SHQIPTAR

Enver MALOKU

Ansambli i Këngëve dhe i Valleve "Drenica" e Skenderajt në 23 edicionet e Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë", që mbahet çdo vit më 6,7 dhe 8 qershor e ka një rekord që askush deri tash nga pjesëmarrësit nuk e ka shënuar. Ky ansambël pesë herë është fitues i çmimit kryesor "Mujë Krasniqi", për nivelin më të lart profesional e artistik të performancës. Historiku i këtij festivali të mirënjohur kudo në Kosovë, Shqipëri, Iliridë. Luginën e Preshevës, në viset shqiptare të Malit të Zi, diasporë e kudo tjetër ku ka shqiptarë, ka një histori të pasur artistike e kombëtare. Për rrugëtimin e tij të gjatë e të bujshëm tregon, kryetari i AKV "Drenica", Arben Veliu. Ansambli "Drenica" u themelua në vitin 1968 dhe përfshin seksionin e instrumentistëve, këngëtarëve dhe valltarëve, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur", thotë Veliu në një bisedë për gazetën "Lyra".

Ansambli "Drenica" u themelua në vitin 1968 dhe përfshin seksionin e instrumentistëve, këngëtarëve dhe valltarëve – si për fëmijë ashtu edhe për të rritur. Përgjatë rrugëtimin të tij shumëvjeçar, përkundër sfidave të shumta nëpër faza të ndryshme të historisë, Ansambli "Drenica" ka shënuar suksese të shumta, duke mbetur një pikë referimi e rëndësishme në kulturën shqiptare.

Ky ansambël as gjatë luftës nuk e kishte ndërprerë aktivitetin, krahas pushkës edhe kënga ishte motivues për çlirimtarët. "Me fillimin e luftës në Kosovë (1998–1999) dhe pas rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari me familje, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u formua "Trupa Artistike Hamëz Jashari". Pas përfundimit të luftës dhe me transformimin e UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, emri i Trupës Artistike u rikthye në formën origjinale, në Ansamblin "Drenica" – Skenderaj.

Me fillimin e luftës në Kosovë (1998–1999) dhe pas rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari me familje, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u formua "Trupa Artistike Hamëz Jashari", emër që mbeti aktiv deri në përfundimin e luftës. Shumë nga anëtarët e asaj kohe vazhdojnë të jenë aktivë edhe sot.

Pas përfundimit të luftës dhe me transformimin e UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, emri i trupës artistike u rikthye në formën origjinale: Ansambli "Drenica" – Skenderaj. Arben Veliu përmend edhe figurat dhe artistët më të njohur të Trupës Artistike dhe të Ansambilit "Drenica".

Figurë emblematike e ansambilit mbetet Hamëz Jashari, i cili përveç se ishte trim i rrallë, u dallua edhe për talentin e tij në këndim dhe artin dramatik. Ai ishte anëtar aktiv i kësaj shoqërie kulturore dhe një shembull frymëzimi për brezat që pasuan. Aktualisht, ansambli numëron mbi 120 anëtarë, nga moshë 5 deri në 75 vjeç.

Ndërkaq, aktivitetet kryesore të ansambilit mbeten Interpretim në instrumente muzikore. Këndim solistik dhe grupor. Vallëzim tradicional. Aktrim dhe shfaqje artistike. Lojëra tradicionale. Rite dhe zakone të lashta shqiptare.

AKV "Drenica" e Skenderajt janë pjesëmarrës të përhershëm në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë" në Klinë.

"Fitues të vendit të parë kemi qenë katër herë, ndërsa disa herë të tjera kemi fituar edhe vendin e dytë dhe të tretë, për çka kemi qenë gjithmonë shumë të lumtur dhe krenarë. Një nga momentet më të veçanta për ne ka qenë edhe fitimi i çmimit të publikut. Pjesëmarrja në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë" ka një peshë të veçantë emocionale dhe kombëtare për Ansamblin tonë, sepse ky festival i kushtohet UÇK-së, heronjve dhe dëshmorëve të kombit. Përmes këngëve dhe valleve tona, ne përpiqemi të ruajmë dhe të përcjellim te brezat e rinj historinë, sakrificën dhe vlerat për të cilat është luftuar.

Për ne, "Festivali "I Këndojmë Lirisë" është një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore dhe patriotike në trojet shqiptare. Vlerësimi ynë për këtë festival është shumë i lartë, sepse ai ka arritur të ruajë seriozitetin, traditën dhe frymën kombëtare ndër vite. Vetë pjesëmarrja në një festival të këtij niveli përbën nder dhe përgjegjësi për çdo ansambël apo grup artistik. Ky festival nuk është vetëm një garë artistike, por një skenë ku ruhen kënga burimore, historia dhe identiteti ynë kombëtar. Ai bashkon artistë nga të gjitha trojet shqiptare dhe krijon një atmosferë të veçantë kulture, respekti dhe patriotizmi.



Baladë për Mujë Krasniqin

Mujë Krasniqit dhe 36 të rënëve
Në Gorozhub, më 14 dhjetor 1998

Kush është ai që zbret nga mali
Është Mujo Komandanti
Është ai, Muja vetë, me njëqind e dyzet
Nga po vjen, nga Tropoja a nga Vlora?
Kah vjen ai shkrinë bora
Vjen në borë vjen në shi
Nga Shqipëria në Shqipëri

As hëna nuk kishte dalë
Rrëze bjeshke atë natë
Vetëm terri shtrihej si gjarpër i zi
Terri që ndante atdheun në dysh
Atdheun e moçëm nën qiellin gri
Dhe pjesën tjetër nën shi... nën shi...

E rruga ishte e largët tek zhdukej në pafundësi
Ai vështron fushat e paskaj të Kosovës
E mendon për zogjtë:
Nuk ka vend më t'bukur fluturimi
Kur flet me lumenjtë thotë:
Është vend i papushtuar
Kur numëron plagët shton:
Vetëm vdekja ia shton bukurinë lirisë

Pastaj zbardh dita e plogësht
Dhe ëndërr e keqe numëron 36 herë
Dhembja shtron gjakun përdhe
Vashat shamizeza ulur nën një breg
Kanë ndalur pranverën e bimët që mbijnë
Diku në një shteg... diku në një rimë

Ai sërish ngrihet dhe nis këngën e moçme
Që këndohej në anët tona:
Nuk po mundem or shokë me fol
Se m'ka ra do gjak në gojë...

(Këtë tekst të kësaj balade të Tahir Deskut, pas disa shkurtimeve e shtimeve, e ka bërë tekst për këngë Ilir Shaqiri)



LIRI PËR ÇLIRIMTARËT

Enver MALOKU

Edhe në manifestime të tilla, siç është Festivali Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë", mendja e zemra është të krerët e UÇK-së të procesi i pa drejtë gjyqësor në Hagë. Atje u dëshmuua pafajësia e ish-presidentit Kosovës Hashim Thaçi, ish kryeparlamentarëve, Kadri Veselit e Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit e të tjerëve, sepse lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e pastër, ndaj edhe kishte ndodhur bombardimi i caqeve ushtarake të agresorit serb nga NATO dhe Amerika mike dhe aleatët tjerë perëndimorë. Lufta e UÇK-së ishte çlirimtare, ndaj edhe fitoi bashkë me ndihmën e Amerikës dhe aleatëve. Ushtria Çlirimtare e Kosovës këtë fitore nuk e kishte arritur lehtë, por me një sakrificë, forcë e qëndresë të pathyeshme, prandaj edhe është themeli i Pavarësisë së Kosovës. Lufta kishte karakter çlirimtar për shtet nacional. Historia nuk mund të rishkruhet. Shqiptarët nuk e identifikuan asnjëherë aspiratën e tyre nacionale me përkatësi religjioze. Substrati fetar, siç është sot e përherë mbetet krejt natyrshëm në privatësinë individuale. Edhe Jakup Krasniqi, në një paraqitje të tij në seancë gjyqësore tha: "unë nuk jam as katolik e as mysliman, jam shqiptar". Ndërkaq, Rexhep Selimi në fjalën përfundimtare, tha "UÇK ishte, ushtri çlirimtare, as parti politike, apo diçka tjetër. Nëse lufta nuk do të përfundonte në qershor të vitit 199, dhe do të zgjaste deri sot, unë do të isha ushtar i saj nëse nuk do të isha vranë, që gjasat ishin të mëdha". Hashim Thaçi, ishte i prerë: "I vetmi vendim i drejtë është PAFAJËSIA". Krerët e UÇK-së janë të pa fajshëm, prandaj edhe Kosova i pret që të kthehen në atdhe. Vetëm Liri për Çlirimtarët. Kryelajmërimi

FITUESIT E ÇMIMIT KRYESOR TË FESTIVALIT "I KËNDOJMË LIRISË" NDËR VITE

Sadri HAXHAJ

Festivali folklorik "I Këndojmë Lirisë", që i kushtohet ditëlindjes së komandantit Mujë Krasniqi, tashmë ka marrë karakter mbarëkombëtar. Nga viti në vit, në të marrin pjesë artistë nga e gjithë gjeografia shqiptare. Në çdo edicion të festivalit, në skenën e tij prezantohen më shumë se 800 artistë, të cilët para adhuruesve të folklorit paraqesin vlerat autoktone të traditës sonë kombëtare. Ndërkohë, si çmim kryesor i këtij festivali është çmimi "Mujë Krasniqi", të cilin për 24 vjet radhazi e kanë fituar artistë nga hapësira të ndryshme të trojeve shqiptare.

Kështu, në vitin 2001 çmimin "Mujë Krasniqi" e fituan këngëtarët klinas Halit dhe Sinan Gashi nga Klina. Në vitin 2002, fitues i këtij çmimi ishte grupi polifonik "Bilbilat" nga Vlora. Në vitin 2003, fitues u shpall SHKA "Zëri i Shalës" nga Mitrovica. Në vitin 2004, çmimin "Mujë Krasniqi" e fitoi rapsodi Zymer Kryeziu nga Mleqani i Malishevës. Në vitin 2005, fituese ishte SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi. Ndërkohë, në vitin 2006 çmimin kryesor të festivalit e fitoi SHKA "Sharri" nga Hani i Elezit. Në vitin 2007, fitues ishte Ansambli i Qendrës Kulturore Folklorike "Mirdita", ndërsa në vitin 2008 çmimi "Mujë Krasniqi" iu dha SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi.

Në vitin 2009, fitues u shpall grupi folklorik "Dervish Shaqa" nga Deçani, ndërsa në vitin 2010 çmimi kryesor "Mujë Krasniqi" mbeti në Klinë, ku fitues u shpallën rapsodët Lekë dhe Gjakë Duhani. Në vitin 2011, fitues i çmimit "Mujë Krasniqi" u shpall "Kurora Labe" nga Gjirokastra. Në edicionin e vitit 2012, fitues ishte Ansambli "Rexhep Mitrovica" nga Mitrovica. Në vitin 2013, pas një konkurrence të fortë, çmimi i parë iu dha një ansambli nga Drenica, përkatësisht nga Skënderaj.

Në vitin 2014, vendin e parë e fitoi SHKA nga Malësia e Tuzit. Për tri ditë radhazi në skenën e festivalit performuan mbi 800 artistë, ndërsa çmimi prestigjioz "Mujë Krasniqi" iu nda SHKA "Dedë Gjon Luli" nga Malësia e Tuzit. Në vitin 2015, vendin e parë e fitoi SHKA "Ilirida" nga Shkupit. Në vitin 2016, fitues ishte ansambli autokton "Rugova", i cili rrëmbeu çmimin kryesor të festivalit "Mujë Krasniqi". Në vitin 2017, çmimin kryesor e fitoi SHKA "Drenica" nga Skënderaj. Në vitin 2018, fitues ishte Ansambli "Shotë Galica" nga Drenasi. Në vitin 2019, fitues ishte Ansambli i Qytetit të Obiliqit.

Për shkak të pandemisë COVID-19, në vitet 2020-2021 festivali nuk u mbajt, me vendim të autoriteteve komunale të Klinës. Në vitin 2022, fitues i çmimit kryesor "Mujë Krasniqi" ishte Qendra Kulturore "Anamorava" e Vitisë. Në vitin 2023, fitues ishte AKV "Mati" nga Shqipëria, ndërsa në edicionin e vitit 2024 çmimin "Mujë Krasniqi" e fitoi AKV "Shotë Galica" nga Drenasi. Ndërsa në edicionin e vitit 2025, fitues ishte AKV "Drenica" nga Skënderaj.

MUSA RACI, RAPSODI QË U KËNDON DËSHMORËVE

Enver MALOKU

Musa raci është rapsod i njohur jo vetëm në komunën e Klinës por edhe më gjerë. Këngën folklorike e ka pasion dhe dashuri të përhershme. Musa merr pjesë në shumë festivale që organizohen në Kosovë dhe Shqipërië po ashtu edhe në përvjetor të ndryshëm që u kushtohen heronjve dhe dëshmorëve të kombit. Me këngë merret shumë herët, qysh si fëmijë. Frymëzimin e kishte gjetur pikërisht në odat shqiptare, duke dëgjuar rrëfime e histori për luftërat e ndryshme gjatë periudhave të historisë sonë kombëtare. "E kisha dëshirë që një ditë të këndoj për dëshmorët heronjtë, për trimërinë e të cilëve flitej e këndohej ne dasma e gazmende të ndryshme. Këndoj që nga viti 1979, kur isha anëtar i SHKA "Jehona e Dukagjinit" të Klinës, thotë Raci, duke kujtuar edhe aksionet luftarake në luftën e fundit, si në Pogradje te stacioni i trenit dhe aksione të tjera. Nga të gjitha festivalet, koncertet e manifestimet folklorike ai e pëlqen më së shumti Festivalin Folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë", që mbahet në Klinë më 5, 7 e 8 qershor, festival tradicional tashmë i përmasave gjithëkombëtare, ku u këndohet heronjve të kombit, luftërave e trimave të njohur, luftës së UÇK-së. Ai që 24 vjet që mbahet ky festival, nuk len natë pa e përcjellë deri në mbylljen e tij, madje edhe hapjen e tij në Çabiq të Klinës, që është edhe vendlindja e Komandantit të shquar të UÇK-së Mujë Krasniqit. Ai edhe luftonte edhe këndonte që na jepte moral e kurajo për ta fituar luftën dhe për ta çliruar Kosovën", kujton Musa ditët e luftës dhe të sakrificës. Musa flet me respekt të madh për heronjtë, ndaj ju këndon atyre, si për profesor Ymer Berishën e të tjerë. Një këngë ia ka kushtuar edhe reporterit të luftës Tahir Deskut. Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë", për Musën është festivali më cilësor me vlera të mirëfillta folklorike. Ai thotë se ka marrë pjesë në shumë festivale folklorike. Së fundit ishte në Tropojë dhe në Kukës në Festivalin Folklorik "Sofra Dardane" ku edhe është paraqitur me një këngë folklorike. Musa Raci është edhe veteran i UÇK-së.



KËNGËN FOKLORIKE E KEMI TRASHËGUAR NGA TË PARËT TANË

Enver MALOKU

Këngën e kam trashëgimi nga gjyshi im, Ali Paci. Ndërkaq me këndu kam filluar në vitet 80-ta me migjen tim Muharrem Ali Paci që kam vazhduar deri sot e këngën nuk do ta ndali kurrë. Kam marrë pjesë në shumë festivale në Shqipëri e Kosovë, kurse në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë" në Klinë marrë pjesë që kur ka filluar tëmbahet ky festival, menjëherë pas luftës. Është privilegj të marrësh pjesë në këtë festival.

Mujë Krasniqin e kam njohur shumë herët por edhe si bashkëlufëtëtar kam pas rastin edhe të këndoj me te edhe me shokë të tjerë si me Daut Gashin Halit Gashin, kurse si grup kam kënduar me Sadri Berishën nga fshati Bardh ish Lladrovic, me Sylejman Krasniqin e shumë e shumë kolegë të këngës. Kemi kënduar edhe me Shkelzen Morinën, Sinan Gashin e shumë tjerë, Naim Sali Krasniqin por edhe me rapsodë tjerë të vjetër, Ali Krasniqin, Osman Sefën. Unë rrjedh nga familja e Ali Pacit, i cili ka kënduar me Bajram Sadikun, babën e Sali Bajramit. Kam qenë anëtar i SHKA "Bajram Curri" të Drenocit, ku atëherë në këtë shoqëri ishte edhe Zyle Krasniqi, që po ashtu ishte anëtare e kësaj shoqërie të njohur të Llapushës e këngëtarë të tjerë të njohur. Më vonë isha edhe anëtar i SHKA "Salih e Feriz Krasniqi", pastaj edhe ia saj "Rifat Berisha" të Malishevës. Kam marrë pjesë në të gjitha festivalet ku edhe disa herë jam shpërblyer edhe me çmime të ndryshme, si në festivalin "Hasi Jehon" në Gjonaj ku edhe kam marrë çmimin e parë", thotë rapsodi i njohur nga Drenoci, Avdyll Krasniqi!

"Mujë Krasniqin e kam njohur shumë herët por edhe si bashkëlufëtëtar kam pas rastin edhe të këndoj me te edhe me shokë të tjerë si me Daut Gashin Halit Gashin. Kemi kënduar edhe me Shkelzen Morinën, Sinan Gashin e shumë tjerë, Naim Sali Krasniqin por edhe me rapsodë tjerë të vjetër, Ali Krasniqin, Osman Sefën. Unë rrjedh nga familja e Ali Pacit, i cili ka kënduar me Bajram Sadikun, babën e Sali Bajramit. Kam qenë anëtar i SHKA "Bajram Curri" të Drenocit, ku atëherë në këtë shoqëri ishte edhe Zyle Krasniqi, që po ashtu ishte anëtare e kësaj shoqërie të njohur të Llapushës e këngëtarë të tjerë të njohur. Më vonë isha edhe anëtar i SHKA "Salih e Feriz Krasniqi", pastaj edhe ia saj "Rifat Berisha" të Malishevës. Kam marrë pjesë në të gjitha festivalet ku edhe disa herë jam shpërblyer edhe me çmime të ndryshme, si në festivalin "Hasi jehon" në Gjonaj ku edhe kam marrë çmimin e parë", thotë rapsodi i njohur nga Drenoci, Avdyll Krasniqi!



Ansambli "Jehona e Dukagjinit"

JEHONA E DUKAGJINIT, PO I JEP JETË KULTURËS KLINASE

Sadri HAXHAJ

Ansambli i këngëve dhe valleve Jehona e Dukagjinit është këtë radhë ka bërë hapjen e natës së parë të festivalit "I Këndojmë Lirisë", më vallen më motive tropojane e quajtur "Sot gëzim ka Klina" e përgatitur nga koreografi i shquar tropojan Deli Metalia.

Drejtori i këtij Ansambli Daut Gashi, ka treguar për historikun e këtij ansambli i cili është themeluar në vitin 2019 dhe aktualisht numëron rreth 20 anëtarë. Edhe pse në kushte të vështira financiare, ansambli "Jehona e Dukagjinit" po vazhdon ti sjell Klinës, një mori çmimesh, duke u nisur nga vendi i dytë në festivalin e vjetëm të Gjakovës deri në grupi më kompletuar, çmim ky i fituar në festivalin "Eshkë e ndezur në Shkelzen" që u mbajt vitin e kaluar në Deçan. Vitin e kaluar në Deçan.

Ky ansambel tubon rreth vetës, instrumentalist, vallëtar, solist, nga mosha të ndryshme duke u nisur prej asaj, 70 vjeçare deri në atë 15 vjeçare, më çrast janë përfshirë tri gjenerata nga e reja, e mesme e deri të mosha e vjetër.

Drejtori Gashi ka thënë se Ansambli ka nevojë për përkrahje më të madhe financiare si nga institucionet komunale e deri ët ato qëndore në mënyrë që kultura klinase të mbahet gjallë më aktivitete të ndryshme. Sivjet ky ansamble është pasjitur më zyre dhe ka kushte ma të volitshme pune, vetëm kërkohet përkrahje më e madhe financiare që ansambli të këtë sa më shumë suksese.



Bisedë më rapsodin Gjokë Duhani, fitues i çmimit "Mujë Krasniqi

TË JESH FITUES I FESTIVALIT MBETESH PJESË E HISTORISË SË TIJ

Sadri HAXHAJ



"Kur këndoj para një mase të gjerë, përjetoj një përzierje emocionesh shumë të forta. Në fillim, shpesh ndjej emocion, sepse kam përballë shumë njerëz që më dëgjojnë dhe më

vlerësojnë.

Me kalimin e kohës gjatë performancës, kjo ndjenjë zakonisht shndërrohet në vetëbesim dhe kënaqësi. Duartrokitjet, reagimet pozitive dhe energjia e publikut më motivojnë dhe më bëjnë të ndihem i vlerësuar. Në momente të caktuara, këngëtari mund të përjetojë një lidhje të veçantë me publikun, sikur të gjithë janë pjesë e të njëjtit emocion. Kjo e bën përvojën edhe më të fuqishme dhe të paharrueshëm", e nis bisedën e rapsodi Duhani.

Sipas tij, Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë" është një nga ngjarjet më të bukura kulturore që kam pasur rastin të përjetoj. Ky festival i ka lënë mbresa të thella, sepse përmes këngëve, valleve dhe veshjeve tradicionale, ai pasqyron historinë, sakrificën dhe shpirtin e popullit tonë. Ajo që e impresionon më së shumti është atmosfera e veçantë që krijohet nga interpretimet plot emocione.

"Çdo këngë duket sikur tregon histori për lirinë dhe përpjekjet e brezave ndër vite. Interpretuesit janë shumë të përkushtuar dhe kjo e bën çdo paraqitje edhe më prekëse. Gjithashtu, veshjet

tradicionale shumëngjyrëshe dhe vallet e bukura popullore i japin festivalit karakter mbresëlënës.

Për mua si rapsod, ishte kënaqësi të shoh se si ruhet dhe përcillet tradita nga një brez në tjetrin. Ky festival nuk është vetëm një aktivitet garues dhe argëtues, por edhe një kujtesë e rëndësishme për vlerat tona kombëtare dhe për rëndësinë e lirisë që po e gëzojmë sot. Ai na bashkon të gjithëve dhe na bën të ndihemi krenarë për identitetin tonë", shprehet Duhani.

Festivali meriton vlerësim të madh dhe duhet të vazhdojë të organizohet çdo vit, sepse është një pasuri e çmuar kulturore për vendin tonë.

Të fitosh vendin e parë në këtë festival së bashku me rapsodin Lekë Duhani, sidomos në 10-vjetorin e tij, ka një domethënie shumë të veçantë, sepse për ta si këngëtarë do të thotë se kanë dhënë më të mirën nga të gjithë pjesëmarrësit. Duhani, shton se "kjo sjell krenari dhe vetëbesim. Ishte një moment jubilar që përfaqëson një dekadë tradite, kulture dhe përkushtimi. Te jesh fitues në një edicion të tillë do të thotë të mbetesh pjesë e historisë së festivalit".



Fatmir Berisha bashkëkëngëtar i Komandant Mujë Krasniqit

NJERËZIT E MËDHENJ, SI MUJË KRASNIQI NUK VDESIN KURRË

Sadri HAXHAJ



Berisha, bashkëkëngëtar i komandant Mujë Krasniqit, tani anëtar i Drejtorisë Artistike të Festivalit "I Këndojmë Lirisë" për kohët që kënga nuk i ndau për asnjë çast.

"Ishin vitet e 80-ta që u njohëm me te dhe bashkëpunimi me Mujën në atë kohë, nisi si anëtar i SHKA "Besa" në Çabiq, por njëkohësisht dhe anëtar i SHKA "Jehona e Dukagjinit" në Klinë. Me Mujën kemi marrë pjesë në koncerte të ndryshme jashtë vendit, dhe ka qenë viti 1988, kur ishim në turneun ndërkombëtar në Gjermani me ç'rast kemi shfaqur koncerte në qytete të ndryshme të Gjermanisë, fillimisht në Berlin, ku kemi kënduar së bashku në duet me Mujë Krasniqin, me këngët "Oj Kosovë vend i pasur" dhe "Lulja e Malësisë".

Po atë kohë në Klinë u themelua edhe SHKA, "Boksitet e Kosovës" në Volljak të Klinës, ku përveç Mujës, dhe Bege Gashit, atë botë bashkë me ne ishte edhe rapsodi i mirënjohur, bashkëluftëtari i komandant Mujës, Beqir Gashi.

Muja dhe Beqa, qysh në atë kohë, treguan talent dhe zotësi në interpretimin e këngës shqipe, talent ky

që nuk i ndau edhe në ditët më të vështira deri në flijimin e jetës së tyre për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ishte kënga dhe inspirimi patriotik që na mbajti një kohë të gjatë të pandarë për të ruajtur dhe kultivuar vlerat e mirëfillta të folklorit tonë, marrë parasysh, situatën dramatike që po kalonte populli ynë gjatë asaj periudhe të sundimit serb. Me fillimin e luftës Muja, edhe nga ilegaliteti vinte shpesh në shtëpinë time që nga ajo kohë, i ruaj kujtimet e freskëta për figurën kolosale të tij.

Sot kur po i këndohet lirisë dhe ditëlindjes së tij, Ideja, për themelimin e festivalit "I Këndojmë Lirisë" ka qenë e qëlluar, sepse sot ky festival po jehon në mbarë shqiptarinë. Edhe në organizimin e festivalit jam i angazhuar tash e 22 vjet dhe jam pjesë e Drejtorisë Artistike bashkë me Halit Gashin dhe Daut Gashin. Bashkë me organizatorët e kësaj drejtorie jemi munduar që gjatë kësaj periudhe të sjellim risi në festival, e këtu vlen të theksohen edhe tri këngët e reja, që ne i kemi sjellë si grup bashkë me Halit e Daut Gashin, kushtuar figurës së Komandant Mujë Krasniqit", tregon Berisha për angazhimin e tij në festival dhe në folklor përgjithësisht.

"Njerëzit e mëdhenj si Mujë Krasniqi nuk vdesin, por ata përjetësohen. Për të sot këndon mbarë shqiptaria, sepse vepra dhe sakrificat e tij do të vazhdojnë të mbetën në kujtesën tonë për t'u kujtuar dhe për t'iu kënduar brez pas brezi". Kështu nis rrëfimin, Fatmir



TRIMI, KËNGA DHE PUSHKA

Shkruan: Bedri TAHIRI

*Mos shikoni plagët e mia,
Por shikoni ku i ka kufijtë Shqipëria!*

(Mujë Krasniqi)

-Merre çiftelinë e krisja këngës, o trimosh, se kullat tona nuk durojnë heshtje e zymtësi.

-Sa ta pijë Hamza kafen, o komandant, do t'ia krisim e do t'ia themi deri sa të zbardhi dita.

Mujë Krasniqi - KAPUÇI

Dhe, s'bëhej pak e tingujt lozonjarë shpërthenin vullshëm, duke i dhënë shpirt odës së madhe të Jasharëve:

*Oj Kosovë e bukur do ta sjellim dritën
Gryka jonë e skuqur ngjall Azem Galicën
Toka jonë e djegur po lahet me gjak
Ty ta falim jetën e na duket pak...*

Bacë Shabani, ulur këmbëkryq, bri oxhakut çemerli, si një orakull ndjellmirë, dëgjonte vëmendshëm dhe ngazëllehej e përjetonte me shpirt. Zemra i bëhej mal me dëborë. Herë here ua hidhte nga një bisht syri luleve të rinisë. O Madhëri, secili më i zoti se tjetri. Sa mirë, mrekullia vetë. Pika e djalërisë. Të tillë ditë kishte ëndërruar moti, edhe atëbotë, kur hienat të përgjonin edhe në gjumë. Dhe, këngë e krisma, krisma e këngë. Kënga del prej grykës së pushkës! - iu kujtua beftë dhe fët i vanë sytë tek armët varur në mur. Të bekuarat, shkëlqenin në të buzëqeshur. S'kishin faj, ashtu ishin mësuar, te pandara, si vëllezërit siamezë. Jetë i thënçin asaj ndryshe! Të dyja tok siguronin pavdekësinë.

Por, ah, të keqen! Kjo dhunti nuk e stoliste secilin. Jo, jo, ajo u takonte vetëm atyre që vrisnin frikën dhe ngulmonin lirinë. Të tillë janë gjithë këta djem, mendoi plaku, duke i fshire ca lot që e kishin tradhtuar dhe heshturazi i rrokulliseshin faqeve të parruara. I tillë ishte edhe djaloshi me zë bilbili e me trup të lidhur deng, që i thoshin Mujë Krasniqi. Sa i ngjaka Ademit!-përfundoi me vete, duke mos ia shqitur sytë.

MENJË LULE S'VJEN PRANVERA

Muaji i bukur i qershive zakonisht vjen me këmbë të mbarë. Ashtu erdhi edhe ai i vitit 1967. Kur hodhi çapin e gjashtë, Çabiqit iu shtua edhe një çifteli, iu shtua edhe një pushkë, iu shtua edhe një gëzim: U lind Mujë Krasniqi!

Ç'është e vërteta, nga kjo derë fisnike, edhe shumë herë të tjera rrodhi gëzimi i jetës. Me një lule s'vjen pranvera,- thoshin Halili e Shehidja, dhe shtonin hisen e tyre e të atdheut. Ndryshe as që mund të mbijetohej zezona që na kërcënonte mbi kokë. Ata lindën njëmbëdhjetë fëmijë. Satanait, që planifikoi ndryshe, i theri fort në zemër dhe klithi përvajshëm:



Më mundi Nëna shqiptare!

Djaloshi topolak rritej me ëndrra të mëdha lirie. Shpirti i tij njomëzak depërtonte thellë e thellë në labirintet e mugëta të historisë kombëtare. Aq shumë u mishërua me këngët historike sa që edhe e morën me vete, e bënë histori...

Lisat e mëdhenj i rrahin erërat më shumë, andaj edhe i lëshojnë rrënjët më thellë. Muja herët u ra në sy pushtetarëve serbo-sllavë. Veprimet e tij atdhetare rrezatonin në gjithë rrethin. Në çdo protestë e demonstratë ishte i pari. Veçan u dallua në ato të vitit 1989. Edhe përndjekjet ndaj tij u shtuan. Por, kot. Arra e fortë nuk thyhej lehtë. Atdhedashuria e tij veçse po rritej e lartësohej deri në ideal jetësor. Tashmë e ndihmonin edhe vëllezërit: Aliu, Avniu e Afrimi.

Kur lëvizja çlirimtare grisi tisin e ilegalitetit, Muja sërish i pari në grupet e armatosura. Në nismë, për ca kohë, qëndruan në truallin e shqipeve, në Prekaz. Adem Jashari kishte besim të plotë tek ai dhe e ngarkonte me detyrat më të rënda. A ndalej dielli të ndriçonte? A pushonte Drini i Bardhë? Aq mund të ndalej a të pengohej Mujë Krasniqi! Orët e tij frymonin në Drenicë, në Dukagjin e në Pashtrik.

LAJMËTARI I DITËS SË RE

Agu i së mërkurës u gdhi fare i zymtë. Qielli i mërrlorur veçse s'lotonte. Drenica ende po nanurisej në djepin e ëndrrave lridashëse, kur lubia e përtej Tunës po futej në zemrën e saj... Sakaq, te lugina midis Llaushës, Rezallës së Re e Rakinicës, dheu u trand në themel.

-Priti matanë, o komandant,- erdhi një zë nga maja e malit përballë.

Edhe tri fishkëllima therrëse, shenja të moçme sulmi, jehuan dhe u përcollën tej e tej lugjeve gojëmëdha.

-Krisja malësorçe, o Mujë kreshniku,- thirri komandant Adem Jashari, që e kishte fare pranë, duke i dhënë zjarr mitralozit të

madh. Helikopteri i gicur në bark, iku lart. Krisma e britma. Tym e flakë. Djajtë e humbën fare. Kukulelet e tyre i përpui Manastiri heshtak...

-Asnjë të gjallë!- thërrisnin mrizet e Llaushës. Mëshirojeni, ore të keqen se u pëlçet zemra si lepujve!- zëronte lumthi zemërbutë. Ha-ha-ha, gajaseshin me qesëndi trimat maje kreshtash.

Bishat e harlisura nga plagët e nga paniku zunë te zhgërryeshin e të iknin se prapthi, si gaforrja. Gjaku i diturisë shënoi orën e madhe të historisë. Një yll u ngrit në qiell. Mësuesi Halit Geci u shndërrua në lulëkuqe lirie.

Lalushë, 28 Nëntor 1997. Lumenj njerëzish vërshuan drejt saj. Të gjithë tok i bashkonte flamuri kuqezi. Gjithë Kosova po vinte aty për ta përcjellë në amshueshmëri mësuesin e dashur. Sakaq, nga kreshtat e larta zbritën edhe tri shqipe lirie. Të gjithë mbajtën frymën. Ndonjëri fërkonte sytë me mosbesim. Sa u shkante uniforma laroshe! UÇK! UÇK! UÇK! ofshëtinë fusha e male.

-Ishim ëndërr apo na bënë sytë?- pëshpëritnin ca, që ende nuk po i besonin vetes.

-Si ore tutkunë, ende mësyheni?! - ua kthyen të tjerët gjaknxehtë e të xhindosur. Kjo është Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që sot e tutje do t'i dalë zot atdheut.

-Ashtu ishte vërtet. Mjaft më, të dalim hapur, gjykuan trimat, dhe zgjodhën tre lajmëtarë të ditës së re: Mujë Krasniqi ("Kapuçin"), Rexhep Selimin ("Dhjetëshin") dhe Daut Haradinajn ("Davidin").

KACAFYTJA

Zjarri i luftës mori krahët e dragoit. Kudo luftohej: në Drenicë e në Llap, në Dukagjin e në Shalë të Bajgorës, në Anadrini e në Pashtrik. Pena e poetit skalit vargjet:

*Kushtrimi del e pushton malet
Në njëqind Drenica ndezën idealet*

As djaloshi i aksioneve të rrufeshme nuk pushonte dot. Trimave u prin fati, thuhej qysh moti. Ashtu ishte, edhe atë e gjeje kudo e kurdo në ballë të fronteve e të betejave. Sa e sa herë u plagos. Por, ashtu, me nëntë plagët e Gjergj Elez Alisë në shtat, kacafytej me bajlozët e zinj, të cilët mëtonin ta nëpërkëmbnin nderin e trojeve tona stërgjyshore. Shumë punkte policore i hodhi në erë e shumë arkivole nisi për në Shumadi.

Më 5, 6 e 7 mars 1998 iu çua zemra në dysh. Medet, nuk mundi t'i shkante komandantit në ndihmë, por kolonës së gjatë serbe, që vinte nga Klina, ia preu rrugën. Bashkë me bashkëluftëtarët e tij shfreu dufin mbi somnambulët e hekurt, duke i paaftësuar. Snjaperi i tij ia kënaqte shpirtin. Për bacë Shabanin!...Për Hamzën!...Për Adem Jasharin!...Për gjithë të pavdekshmit!...Kështu i numëronte ata që i çonte në atë botë. Edhe më vonë avazi i njëjtë. Luftë, beteja, sakrifica. Me muaj e mbajti vijën luftarake Kijevë-Dollc-Dush. Dy muaj kalitje në frontet e luftës është njësoj si të mbarosh një akademi ushtarake,- thoshte një oficer i lartë shqiptar.

Në betejën e korrikut mbi shtatëmbëdhjetë orë qëndroi i palëkundur në istikam. Stoicizëm i pashoq. Taktika e tij luftarake qe e thjeshtë dhe unikate: i pari futej në front e i

fundit tërhiqej. Nisur nga kjo, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, më 19. 8. 1998, e emëroi Komandant të Brigadës 113.

-Rroftë Komandant Kapuçi!- brohoriten luftëtarët që e donin shumë, saqë jehuan edhe male e fusha përreth.

Trimi syptrembur në beteja përdorte edhe armën tjetër-këngën. Kur këndonte për legjendarin, të gjithë ngriheshin në këmbë dhe ishin të gatshëm për t'u hedhur në grykë të topit:

*Na u bën kala kullat me bedena
Prapë n'këtë tokë po rriten Hamza e Adema
Amaneti i tyre ta fitojmë lirinë
Me pushkë mbrojmë Kosovën e nderojmë Shqipërinë*

Koha ecte me ritmin e saj e ofensivat serbe nuk kishin të ndalur. Edhe numri i vullnetarëve rritej e rritej. Armët e municioni mungonin. Komandanti harroi plagët dhe u priu drejt Alpeve Shqiptare.

RËNIE E MADHËRISHME

Vallë ç'kishte Hasi i Thatë i Prizrenit që lotonte në heshtje mëngjesin e 14 dhjetorit 1998?! Këtë kurrë nuk e kishte pasur zakon. Lotët nuk ia pa kush as kur osmanët e zhvarrosen më të dashurin e tyre, Pjetër Bogdanin e madh, as kur cerberët nga pusia ia vranë atë Shtjefën Gjeçovin mendjendritur. E sonte ç'kishte që ishte ligështuar aq shumë?!

Një gjëmë më e madhe se ato e kishte pllakosur këtë fundvit të acartë. Një tog ushtarësh të lirisë kishte ngelur në pritat kobtare serbe...

...Ora 2 e 10 minuta. Terri i natës skëterrë u bë copë e grimë. Vëzhguesit pararojë ranë në pritë!

-Tërhiquni prapa!- bërtiti me gjithë zë komandant "Kapuçi", duke zënë pozicion me shpejtësi rrufeje.

Dhe, sa keq! Lufta u ndez ashpër. Qielli u zbardh nga flaka e armëve. Komandanti, si përherë, në mbrojtje të bashkëluftëtarëve. Fare pranë edhe i vëllai, Aliu, edhe dhëndri Beqiri, edhe Rifat Mëziu, edhe...

Komandant Mujë Krasniqi duke u kthyer nga Shqipëria O Zot! Gorozhupit i treti fare qetësia.

Çirrije...britma...lemeri...Heroizëm...qëndresë...mbijetesë. Krismat vinin duke u rralluar. Nuk po dëgjohej më as arma e komandantit. Të gjithëve u vajti mendja për keq, por s'folën. Nuk u bente zemra. Gjaku i lirisë ujiti gurët e kufirit ndarës. Tridhjetë e gjashtë lulëkuqe stolisen dëborën e acartë... Edhe nëntë të zënë robër.

Por, fati u ra pas, në Shalë të Bajgorës u kapën tetë ushtarë serbë...

Dhe, pasoi këmbimi i tyre.

Një barasvlerësim shtetesh...

-Jam krenar që pata djem të tillë!- thotë xha Halili pasditën e ftohtë të 20 dhjetorit 1998, kur po i varrosnim në Kodrën e Dëshmorëve, në Polacin e Hasan Prishtinës...

-Burrat matën në ditë të vështira, bente një plak gungaç, mbështetur në kërrutën e tij prej dëllinje.

Lavdi për jetë e mot Dëshmorëve të Lirisë!

Respekt e nderim të pavdekshmit Mujë Krasniqi!

Muja i këndonte lirisë!

ÇDO GJË FILLON DHE PËRFUNDON ME LIRI!

Shkruan: Shaqir FONIQI



Kur një njeri është njëkohësisht edhe luftëtar edhe këngëtar, ai bëhet, në të njëjtën kohë bëhet edhe forcë e Lirisë! Muja, nuk luftoj vetëm me armë, por edhe me fjalë e melodi, që zgjonin zemrat e njerëzve! Ai, në çdo fushëbetëje tregoi guxim dhe sakrificë, Ndërsa përmes këngës, mbajti gjallë, moralin, motivimin për mos t'u dorëzuar shpresën për Liri Këngët e Mujës nuk ishin thjeshtë argëtim, por mesazhe që bartnin dhembjen, krenarinë dhe dashurinë për Atdhe, për të cilin ra me krenari e nder! Muja-hero, luftëtar e këngëtar, u lartësua në altar, duke u bërë simbol i lirisë, gjësë me të shtrenjtë dhe të çmuar për një komb që gjakon Lirinë!

*Për dashuri jep jetën,
për Liri jep dhe dashurinë.*

*Nëse nuk vonohesh, të pres tërë jetën!
(Shandor Pëllëfi)!*

Kombet e mëdha lirinë e kanë mbi të gjitha, sepse sipas kokave të tyre të mençura, çdo gjë fillon dhe përfundon me Liri! Në këtë plan edhe shqiptarët, ndonëse nuk janë komb i madh, synimet dhe dëshirat për Liri i kanë pasur përherë të mbjella në gjak! Ndonëse, të nëpërkëmbur e të pushtuar, ata kurrë nuk janë dorëzuar! (Mos më thuani se kemi abuzuar me Lirinë se nuk arrini me më bindë. Individët e tillë, nuk e

kanë dashur kurrë Lirinë)! Historinë e kam dëshmitare se, ky komb e kjo tokë, kurrë nuk kanë mbetur pa Zot! Populli shqiptar është populli i vetëm në Ballkan, që kurrë nuk ka devijuar nga trangu iliri-dardan! Nuk ka nevojë ta shfletojmë historinë mijëra vjeçare, për të konstatuar se kombi ynë gjithmonë e ka dashuruar Lirinë dhe kurrë nuk ka pranuar me qenë i pushtuar! Të marrim vetëm 32 vitet e fundit dhe të bindemi se shqiptarët kanë bërë sakrificat të mëdha për të arritur, këtu ku jemi e do të jemi. Dy korriku i vitit 1990, ishte tharmi i Pavarësisë së Kosovës. Pikërisht atë ditë delegatët e Kuvendit të Kosovës, shpallën Deklaratën e Pavarësisë, kurse me 7 shtatë shtator edhe Kushtetutën e ashtuquajtur të Kaçanikut! Për 2 korrikun shqiptar dhe 4 korrikun amerikan, do të shkruaj në këtë shkrim, në vazhdim. (Pë dy korrikun e Kosovës, ekziston një pllakë dhe një rrugë qorre)!! Ishte kohë për vdekje a liri. Tankset serbe e kishin nxjerrë Kosovën, kurse Kuvendi ishte blinduar. Megjithatë, delegatët, duke përfillur vullnetin e popullit, e shpallën Deklaratën historike të Pavarësisë. Pastaj e dini si rrodhën gjërat! U suprumua gjithçka. Kosova ishte okupuar keq. Kosova ishte bërë serbomadhi! Por, asgjë nuk ndodh pa një skenar, diku nën rrogoz!



PUSHKA DHE KËNGA PËR LIRI

Shkruan: Enver MALOKU



Kosova është rritur, është njohur përmes luftërave çlirimtare. Pjesë e saj, e lavdisë e krenarisë e kanë përcjell popullin në të gjitha periudhat e historisë, gjë që shpesh shtrohet pyetje se cila është më vjetër, lufta apo ky truall arbëror, apo nuk mund të ndahen. Ekziston pyetja dhe njëkohësisht edhe përgjigja, sa e lashtë po aq domethënëse. Prej kur janë këtu shqiptarët? Përgjigja gjithmonë e menjëhershme ishte: Prej se ekziston dreqi, apo den baba den. Prandaj edhe u thurën u kënduan aq këngë për luftërat, trimat heronjtë e këtij vendi. Kjo është krejt e natyrshme sepse kjo tokë është larë me gjakun e bijve e bijave më të mira. Ka rrjedh gjaku si lum, por kurrë nuk u ndal ky popull në kërkim të lirisë e të pavarësisë. Të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë e Kosovës kanë hyrë në historinë e e dëshmorëve të kombit. Sa e sa kënga këndohet rritën ndër luftëra. Ato ishin regjistruesi më i mirë i të gjitha luftërave të stuhishme e të përgjakshme ndër shekuj. Thënia e vjetër latine "Fjalët i merr era shkresa mbetet" të shqiptarët ka mundur lirisht të ishte "Fjalët i merr era, kënga mbetet". Dhe vërtet kënga ka regjistruar gjithçka, e cila ka vazhduar të jetë mesazh e udhërrëfim për gjenerata brez pas brezi. Është luftuar në të gjitha kohërat, në kohë pa kohë, me armë e pa armë, por përpjekja titanik nuk ka përfunduar kurrë, deri në çlirimin definitiv të vendit. Ushtria Çlirimtare e

Kosovës ushtria më e njohur që njeh historia. Prandaj, merita më e madhe i takon asaj, pjesëtarëve të saj, gjakut të derdhur të bijve e bijave më të mirë të kombit. Rrjedhimisht kjo ushtri është ushtria më e lavdishme e popullit shqiptare cila e ndryshoi rrjedhën e historisë. Lufta e saj jo vetëm që ishte e armatosur por edhe shumë dimensionale. Në shumë fronte duhej luftuar, në at ushtarak, politik, diplomatik e informativ. Në të gjitha UÇK ka dal fituese. Sa e sa gënjeshtër ishte thurur për këtë popull e luftën e saj nga propaganda serbe, të cilët dhelperishtë e dinakërisht përhapnin gënjeshtër, duke pretenduar se gënjeshtër e tyre është e vërteta. Madje ato përsëriteshin me dhjetëra herë që mos po u beson edhe dikush tjetër pos tyre. Kënga dhe pushka ishin tmerri i armikut. Dhe jo vetëm pushka e kënga por edhe veshja kombëtare, tirqit, plisi, xhubleta. Para pamjes së shqiptarëve armiq të tmerroreshin. Për shumë epoka gjendet motërzimi i ngjarjeve. Rrëmbimi i mbretëreshës ilire Teutës nga toka ilire dhe ekzekutimi i saj përtej detit nga romakët. Numrat e ushtarëve shqiptarë të vrarë në luftëra e beteja të ndryshme poashtu. Viti 1830, përballjet e përgjakshme me osmanët, dredhitë kurthet e armiqve. Kujtesë historike e dhimbshme, tragjike përkujton atë vit të thyer, masakrën, plojën në Manastir, nga pushtuesit e egër tuq, 500 shqiptarë u ekzekutuan në një hipodrum të këtij qyteti, sot është stadium futbollit. Ishin të zgjedhurit, paria e të gjitha vilajeteve, nga Janina, Kosova e Shkupi, si personalitete të tjera elitarë të kombit të dijes e të pushkës. Ishin ftuar në një "akt solemn "për plotësimin e kërkesave dhe arritjes se një marrëveshjeje. Në hyrje u thonë t'i lënë armët, është ceremoni gëzimi. Posa hyjnë brenda, pason breshëria nga ekspeditat dhe eshalonët e pushkatimit. Për ne bilanc tragjik, për turqit jo edhe aq, ndonëse kishte të vrarë e dhe nga ata, sepse në këso rrethanash ishin vrarë edhe 130 ushtarë e vezirë turq. Dhe në pyetjen si ndodhi kjo, përgjigja ishte: koloriti i i ngjyrave të kostumeve të shqiptarëve ua kishte verbuar sytë për goditje në shënjestër. I madhi Kadare i bënë këto përshkrime në një nga shkrimet e tij. Pra ishin tirqit galana të Kosovës, ata të bardhë me 12 fije gajtana të Dukagjinit, fustanella labe, plisi i rrumbullakët i Kosovës, ai dibran paksa i shtypur e qelshja e jugut të Shqipërisë. Kënga ishte edhe himn ndër beteja, edhe vajë edhe krenari edhe pikëllim por edhe gëzim. Poema e Pashko Vasës "O moj Shqypni, e mjera Shqypni", i ka të gjitha, që është elegji, brengë dhe kushtrim, e që gjenden vargje të njohura, që sot e kësaj dite këndohen nga rapsodë me lahutë e çifteli. "...Ka pas kenë një zojë e randë burrat e dheut të thirrnin nanë...". Edhe femrat shqiptare, këndonine, por edhe vajtonin. "Mblidhuni ju vajza, mblidhuni ju gra, me ata sy t'bukur që dini me kja". Pra i bënë thirrje kombit, burrave e grave për shpëtim. Vajzat, grat me sy t'bukur, shpjegonin vuajtjet, ndaj rrokja e shpatës ishte domosdoshmëri. Kënga thërret edhe vajzat e gratë pa mbulesa të japin edhe ato për kombin. Natyrisht me sy t'bukur, e për ta parë botën. Femrat shqiptare, në terrin osman i kishin sytë e mbyllur nga mbulesat me perçe. E gjatë, e vështirë dhe e mundimshme ishte rruga për liri. E popull të çliruar nuk ka pa shtetin sovran e të pa varur heroizëm dhe shpresë të re kombëtare. Koha nuk fsheh gjithçka. Okupim klasik. Gjaku i tyre i derdhur, poashtu është atdheu i lirisë. Kur kënga dhe sfondi i saj i përket thellësisë së errët. Atëherë kur vaji këndohej, e kënga ishte vaj. Kur të heqësh dorë nga lufta ke heq dorë nga jeta e madhe. Por lufta nuk është gjithherë e armëve dhe e vdekjes. Lufta dhe vetëm ajo do të bëjë prerjen e kostumit të lavdisë dhe vend zënien në fronin. E pra çlirimtarët janë histori e njerëzve të mëdhenj, pra edhe biografi e çlirimtarëve. Ushtria Çlirimtare e Kosovës i doli zot atdheut. Pa te nuk do të vinte as liria e as pavarësia. Ajo bëri luftën çlirimtare. Krerët e saj sot pa drejtësisht po mbahen në Hagë. Gjykata e Hagës nuk është gjykatë e drejtësisë por e pa drejtësisë. Krimet i ka bërë Serbia. Nuk ka fshat e vendbanim në Kosovë që Serbia nuk ka bërë krime. Dëshmi varrezat e dëshmorëve, martirëve, të civilëve, gra, fëmijë, pleq. Kosova i pret bijt e saj që të kthehen. Krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi e Jakup Krasniqi janë të pastër si kristal për luftën e drejtë që kanë bërë. Kosova e pret kthimin e tyre në atdhe.

MISIONI I DYFISHTË I ÇLIRIMTARËVE

Shkruan: Rexhep KASUMAJ



(Mbi një çorientim qytetnë)

1. Pushtimet janë të ndryshme. Por ato klasike, me ushtarë e regjime, sikur ndalojnë jetën. Synojnë doktrinarisht ndërrimin e popullit ose shfytërimin shpirtëror të tij. Pastaj pushtuesit diferencohen dhe brenda llojit: barbarë që vuajnë deficitin e thellë kulturor, dhe të tjerë që i përkasin një qytetërimi të lartë. Aziatët osmanë, obskur si asnjë tjetër, për 500 vjet, fjala vjen, do të hidhnin vetëm pëlhurën e territ dhe injorancës. Madje, ia dolën një kohë të përzhnin tragjikisht flamurin e fesë dhe kuptimin e kombit. Ndërkaq, si një antibiotë, në vitet e pakta të pushtimit italian u hapën shkolla e kolegje në të gjithë hapsirën arbnore. Madje, dhe në Kosovën e harruar nga koha. Tani duket një paradoks ngaqë, ndërsa në kulturë e jetë publike hymnizohej pushtuesi, rendi dhe sundimtari, njëkohësisht, ndriçimi shpirtëror përnxiste dyshimin, ndërjegjen kritike dhe vullnetin e lirisë. Haxhi Zeka, një tribun popullor paskësh thënë: të lidhemi me Inglizin (Britaninë gjithbotshme). Është i fortë, i ditun dhe i largët. Sado të qëndrojnë këtu, shkon një ditë... Një intuete krejt popullore, ai shpaloste dhe një klasifikim tjetër pushtuesish: të afërt e të largët. Një ndarje që, vërtet, i përkon historisë politike të botës.

2. Otomanët e largët, viti 1912, u ligështuan e molepsën dhe ikën të ndjekur dhe nga luftëtarë shqiptarë. Por si një mallkim, fesi turk do të merrte, papritur, një çmim që ndante jetën e vdekjen. Ishte një lehtësi që kush e mbante mbi kokë nuk ndiqej nga ushtritë serbiane. Thjeshtë pse serbët, këta pushtues të afërt fqinjësor, nuk vrisnin turq. Ata ishin thyer e humbur, por shqiptarë. Vrisnin, ndaj, plisbardhët e lodhur nga errësira, vuajtja dhe mjerimi i gjatë. Përse? Pasi, në mallkim të Kongresit të Berlinit, 1878, i kishin dëbuar egërsisht nga

thellësi e territoreve tyre etnike (në Serbinë e sotme të ekspanduar), pushtuesit e rinj sllavë caksynonin spastrimin etnik dhe dealbanizimin përfundimtar të Kosovës! Ëndërronin matanë, Adriatikun e bukur... Pastaj ndër vite, Gjermania ariozofike do të rrëzonte mbretërinë serbiane. Dhe një dritare e vogël do të hapej. Me të mbaruar të luftës së dytë botërore, një kohë e shkurtër autonomiteti rafinonte modelin e pushtimit të vjetër. Por, pa vonuar gjatë, viti 1989, pushtimi zuri të rikthente përmasën dhe formën klasike. Shqiptarët shpallëshin popull i ndaluar në Kosovë e me vise rreth saj. Por ata që tani janë shndërruar në heronj, legjenda e përmendarë, i dolën zot tokës së atdheut. Popullit të nëpërkëmbur. Ishte djemëria e Ushtrisë çlirimtare dhe prijësit e tyre që do bënin realitet ëndërrën e fisme të lirisë, të vjetër sa bota. Emrat e tyre lavdiplotë, të gjallë a flijuar, janë manifest i idesë kryengritëse dhe alfabet i luftës për çlirim kombëtar! Por ata nuk u ngritën me armë e gjak vetëm për lirinë politike. Të mbështetur nga aleatët petëndimorë në Orën e madhe të historisë, u vetëmohuan dhe për dëlirjen e shpirtit shqiptar nga mbetjet kulturore të pushtuesve të egër e inferiorë. Kujtoj shpesh Presidentin e Shqipërisë R. Mejdani, tek në kulmin e luftës, ndërsa disfata e Kosovës afrohej e ligë si vdekja, me sy të përplotur e buzë që i dridheshin, apelonte në Tiranë: Europë (e nënkuptueshëm dhe Amerikë si bija e saj) shpëtoje popullin e Nënë Terezës! E, natyrisht, si i tepërt mbi këtë Dhe, edhe gjaku shqiptar. Por gjaku, mjerisht, s'do të mjaftonte. Ende ka popuj që gjakosen ditë e natë, por agu i lirisë, nga hiri i zi i gjeopolitikës fatale, nuk përqaset dot. Europa, prandaj, një pararojë e Amerikës, erdhi. Me ushtarë lirie e institucione demokracie, duke hapur portën e harruar të Shtëpisë, nga kishin mërguar shqiptarët n'për qindvjeçarë. E pra, çlirimtarët do të luftonin për të kristalizuar poaq anëmarrjen civilizuese e identitare të kombit të lashtë shqiptar! Ndaj, s'kishin luftuar, si do të thoshte Kadare, që në mbrëmje të ngrysen shqiptarë dhe në mjes të zgjohen myslimanë me shpirtin e trafikuar!

3. Tani gjurmë të temës na shpiejnë në turbullimën e viteve që jetojmë. Aty ku shpirti kombëtar përjeton sprovën e rëndë. Janë hanxharët e padukshëm që vrasin pa britma dhe gjak. Pikërisht ajo midiskoha e gjatë fijejëputur, sikur bën akoma rojë frike në agun e zgjimit. Trazon frymën e përhumbur. Ndrydhë akoma ëndërra dhe errëson horizontin e ri. Takoja kohë më herët, një muzgu të bukur Prishtinë, të njohur e miq të tyre që jetonin në Europë. Në Dhe të largët, thoshin. E tillë, në fakt, ishte më shumë për gjeografinë e më pak për kulturën sepse, anise një kohë fillhumbur, ishte Vendpari ynë i vjetër. Dhe, pas bredhjes ndër tema e derte ngulimi, biseda kthehej prorë në një pikë: në folenë e mëkatit...A nuk është atdheu gjithmonë një faj i pashlyer? Kujtoj ende një tyresh nga rrethinat ku takohen Kosova e Ilirida, që do të shfaqej përtallës mizor i lirisë. Jemi të lumtur, thoshte, me një shikim

që i ndrinte, sepse tani ushtrojmë fenë lirisht. Identifikimi i lirisë kombëtare me fenë ishte, ndaj, shteg i hapur i denatyrimit: varfëri ndjenjash e mendimesh për truallin amtar. Dhe duket të jetë shokë shumë...Përherë e më tepër gjithandej hapsirës kombëtare...

4. Si ndodh, pra, në ç'skuta të fshehta shpirti, ftillohet ngasja e errët mizore për të qenë rob? Në koleksionin mesjetar të teknikave të torturës ndër vite paskësh dhe një të habitshme. Të rrallë. I pandehuri mbahet disa muaj në terr dhe, pastaj, papritur nxirret jashtë me detyrimin për të shikuar ngulthi diellin. Dhe, i gjori, verbohët në çast. Çfarë fatkobi! Të verbohesh pikërisht nga drita e ëndërruar! Teksa kujtoja këtë mjerim njerëzor, do t'më vinte një shtysë krahasimi simbolik. Athua të ketë një ngjashmëri? Që shqiptarët e robëruar gjatë të kenë mjegulluar (nëse jo humbur) sytë nga drita e fortë dhe e beftë e lirisë, që kërkojnë sërish terrin e vjetër? Si të shpjegohet ndryshe një ndërkalesë e brendshme, e padukshme, e zezë dhe vetëhumbëse? Jetojnë (në

Kosovë) agime të bardha lirie. Iluminim. Qytetëri. Mirëqenie. Rend demokracie. Dhe Botë të civilizuar që bën rojë në pragun e lirisë së tyre Por, për çudi, në shpirtin e lodhur (të një pjese akoma të paktë) ngjizet një ëndërr makabre. Makth, tashmë i parë natës së gjatë. Zjarri që përvëlon. E që merr formën e veprimit hovtar. Për se? Për t'u kthyer prapë në parzmin e robërisë! Dhe, ashtu, bëhet rrotullimi i rëndë e humbak: nga pushtimi i vjetër otoman tek pushtimi i ri serb e, pastaj, ndërkoja e lirisë dhe sërish ikja e brendshme, shpirtërore prej saj në strehën e pushtuesit të vjetër otoman. Ndryshimi i vetëm është se tani pushtimi nuk është me fushime, heshta e shqytarë, por, disi, i prajshëm e virtual. Hyn ngadalë e thellë në strukturën shpirtërore. Në botëvështrim, në kulturën e jetës, në mbylljen brenda llojit, në përceptimin politik, madje dhe në rivlerësimin e historisë. Kjo e fundmja, ndërkaq, ngjan të jetë më e liga: përmbysen konceptet themelore teorike mbi lirinë dhe skllavërinë! Më rrënimtare akoma: në indin identitar meqë, si dihet, feja aty merr ujëm... Dhe, si kurorë, robëria

shpallet kohë lulëzimi jetik, kurse, e përmbysur krejt, liria quhet skllavëri, degjenerim, çorientim kombëtar!

5. Çfarë të thuhet, së mbrami, kur njeriu gëzon lirinë për të zgjedhur dhe zgjedh pikërisht humbjen e saj? Nëse socializmi është një shtrat i gjerë lirisht, ironizonte bukur Kërlezha i madh, atëherë duhet të njohë dhe të drejtën e marrëzisë! E, në këtë frymë, unë do të thoshja: demokracia që lë nën hije atë me pafundshmërinë e të drejtave, pse të mos njohë dhe të drejtën e skllavërisë vullnetare të njeriut? Dhe e njeh, vërtet. Por deri aty ku ajo mbetet private. E drrnuar. E pavërejtshme. Pa ornamentikë. Pa ideologji. Pa program. Dhe pa politikë e rekrutë nën urdhër... E pra, zgjedhja e lirë - lirinë për të humbur, a s'është një mallkim? Sigurisht, por përse vallë?! politike. Të mbështetur nga aleatët E pra, zgjedhja e lirë - lirinë për të humbur, a s'është një mallkim? Sigurisht, por përse vallë?! R. (Maj, 2026)

JURIA PROFESIONALE E FESTIVALIT FOLKLORIK MBARËKOMBËTAR “I KËNDOJMË LIRISË”

Juria profesionale e Festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë”, gjatë tri neteve konkurruese përcolli më vemendje, ansamblet, grupet e rapsodet që përformuan në festival. Juria është në përbërje: Shaqir Hasi, profesor i muzikës dhe kryetar i jurisë, dhe anëtarët, Deli Metalia, koreograf dhe Albina Hyseni, profesoreshë e muzikës.



NË NDERIM TË EDICIONIT XXIV TË FESTIVALIT FOLKLORIK I KËNDOJMË LIRISË, NË KLINË.

(Shkëputje për Mujë Krasniqin, nga libri im "Ata hynë vetë në këngë")

Prend BUZHALA



1.

Tek i afroresh themeleve të kullës-legjendë të komandantit dëshmor Mujë Krasniqit, do ta ndjesh një frymim të veçantë: shpalosjen e flamurit lart në qiell në shtizat e përjetësisë, aq krenar e aq I përzishëm, sikur i ngërthen baladat e legjendat e kohës më të re, që mbajnë në palcën e vet shumë gjëra ende të parrëfyera. Aty vigjilojnë tri figura në një lapidar përnderimi: i komandant Mujës, i vëllait të tij dëshmor, Ali Krasniqit dhe i Beqir Gashit nga Mleqani, mik e shok arme I Mujës. Baladat e legjendat do të arrijnë t'i shquajnë vetëm jeta e veçantë, bëmat e veçanta, vetëflijimi supreme.

2.

Heroi dëshmor Mujë Krasniqi (i lindur më 6 qershor 1967 në fshatin Çabiq të Klinës, i rënë në luftën e UÇK, më 14 dhjetor 1998) ishte edhe vetë rapsod. Ai i frymëzonte bashkëluftëtarët për t'u hedhur në zjarrin e luftës. Ai i këndonte në zjarrin e luftës Adem e Hamëz Jasharit, Luan Haradinajt, këndonte për komandantët Fehmi Lladrovci e Abedin Rexha, Besnik Restelica etj. Atë e shoqëronin në këngë e luftëra vëllau Aliu, Beqir Gashi e bashkëluftëtarë të tjerë. Porse ai vetë, me dëshmorë të tjerë, hyri në këngë, në histori e në artet tona. Luftoi e këndoi, së fundmi, për të hyrë edhe vetë në këngë:

*Kur këndon Beqa flet shqiptari
T'gjithë heronjtë ngriten prej varri
Muja trim i prin kolonës
I rreshton në ballë t'Kosovës.
Kënga e tyre atdhetare
Nuk vdes dot as ndër varre,
Muja, Beqa në një bankë
Tash u kthyen vetë në kangë.*

Kështu këndon rapsodi bashkëluftëtar sot, Halit Gashi, tekstin e Fadil Demakut e me muzikë të Naim Gjoshi. Varret e 37 dëshmorëve vigjilojnë në Polacin e Drenicës. Por ata sot jetojnë në lirinë tonë. E kënga e tyre vjen duke I tejshkuar hapësirat e përjetësisë. "Ai sot jeton në lirinë e të gjithëve", thekson kolonel Hysni Shabani. Në njëvjetorin e rënies së tij, ishte te kulla e tij e djegur edhe një mysafir I lartë nga Belgjika, tek e bënte vëllazërimin e dy komunave, të Klinës e e të Namyrut. Me atë rast, mysafiri i lartë belg, në emër të popullit të Namyrut, kërkon një minutë heshtje dhe i pik loti për komandantin. Sepse kjo ushtri kishte finalizuar çlirimin e Kosovës., duke qenë shpresa e këtij populli të shumëvuajtur, për një periudhë shumë të shkurtër dyvjeçare, por duke punuar në ilegale me dekada te tëra. Ishte krenari që e imponoi një periudhë historike, për t'u radhitur krahas aleatëve të NATO-s.

3.

Mujë Krasniqi ishte edhe vetë rapsod. Ai i frymëzonte bashkëluftëtarët për t'u hedhur në zjarrin e luftës. Ai këndonte në zjarrin e luftës Adem e Hamëz Jasharit, Luan Haradinajt, për komandantët Fehmi Lladrovci e Abedin Rexhës, Besnik Restelicës. Atë e shoqëronin vëllau Aliun, Beqir Gashi e bashkëluftëtarë tjerë. Porse ai vetë, me dëshmirë të tjerë, hyri në këngë, në histori e në artet tona. Kurse figura e Mujës do t'i tërheqë e do t'i frymëzojë krijuesit në shpalimin e dy aspekteve të personalitetit të tij: në atë të vetëflijimit e në atë të këngës folklorike si rapsod, meqë edhe vetë ishte rapsod. Kështu, bashkëluftëtarë, bashkëvendësi e bashkëkëngëtarë Halit Gashi do ta ketë ndjerë së thelli humbjen e Mujës. Prandaj, në të dy tekstet e këngës ai e pikëzon me art të rrallë muzikor interpretimin e tij. Janë "Sot bilbilit iu ndal kënga", me tekst të Fadil Demakut e me muzikë të Naim Gjoshit, si dhe "M'ka marrë malli me ju ndigju", me tekst të Tahir Deskut e Rexhep Selimit e me muzikim e interpretim të vetë Halit Gashit, identifikimi bëhet i plotë:

*Bashkë këndojmë një këngë të re
Që po thuret tash për ne
Zëri m dridhet, qiftelia,
Sa e shtrenjtë qenka liria.*

ÇABIQ



PANAIRI I PRODHIMEVE VENDORE



NATA E PARË



NATA E DYTË



24 VJET FESTIVAL

Që nga themelimi i Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë" tash e 25 vite nuk u ndal kurrë jehona e këngëve folklorike, madhështia e valleve tradicionale dhe promovimi i vlerave kulturore e kombëtare përmes këtyj festivali, që mbledh në qytetin e Klinës ansamble, grupe artistike, këngëtarë, rapsodë e mysafirë nga të gjitha trevat shqiptare. Festivali Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë" mbahet për të nderuar luftën heroike të Komandant Mujë Krasniqit "Kapuçit", në fshatin e tij të lindjes në Çabiq dhe realizohet për tri netë me radhë në Sheshin "Mujë Krasniqi" në Klinë me datat 6, 7, dhe 8 qershor me një program të pasur artistik.

Që nga themelimi me vendim të Kuvendit Komunal të Klinës festivali realisht këtë vit shënon 25-vjetorin e tij, mirëpo si shkak i pandemisë globale gjatë viteve 2020-2021, nuk u realizua. Festivali ka karakter garues, në kuadër të të cilit ndahen 15 çmime, ku kryesori është Çmimi "Mujë Krasniqi", pastaj vendi i dytë dhe i tretë. Si dhe ndahen edhe çmime të tjera si: grupi më i kompletuar, veterani i festivalit, instrumentisti/ja më i mirë, koreografia më e mirë, veshja më autentike etj. Vlerësimi bëhet nga një juri profesionale, që përcaktohet nga këshilli organizativ i festivalit dhe çmimet ndahen në natën e tretë finale. Veç programit artistik, përgjatë realizimit të festivalit zhvillohet edhe Panairi i Prodhimeve Vendore Bujqësore dhe Artizanale.

FITUESIT E ÇMIMIT KRYESORË "MUJË KRASNIQI" NDËR VITE

- 2001 - Halit e Sinan Gashi nga Klina
- 2002 - Grupi Polifonik "Bilbilat" nga Vlora
- 2003 - SHKA "Zëri i Shalës" nga Mitrovica
- 2004 - Rapsodi Zymer Kryeziu nga Mleqani i Malishevës
- 2005 - SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi
- 2006 - SHKA "Sharri", nga Hani i Elezit
- 2007 - Ansambli Qendra Kulturore Folklorike "Mirdita" nga Mirdita
- 2008 - SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi
- 2009 - Grupi folklorik "Dervish Shaqa" nga Deçani
- 2010 - Rapsodët Lekë e Gjakë Duhani nga Klina
- 2011 - "Kurora Labe" nga Gjirakastra
- 2012 - Ansambli "Rexhep Mitrovica" nga Mitrovica
- 2013 - SHKA "Drenica" nga Skenderaj
- 2014 - SHKA "Dedë Gjolluli" nga Malësia e Tuzit
- 2015 - SHKA "Ilirida" nga Shkupi
- 2016 - Ansambli autokton "Rugova" nga Peja
- 2017 - SHKA "Drenica" nga Skenderaj
- 2018 - SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi
- 2019 - Ansambli i Qytetit "Obiliq" – Obiliq
- 2022 - Qendra Kulturore "Anamorava" – Viti
- 2023 - AKV "Mat" Shqipëri
- 2024 - SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi
- 2025 - SHKA "Drenica" nga Skenderaj



KLINË - KOSOVË

EDICIONI 24-të

6, 7, 8 QERSHOR

FESTIVALI FOLKLORIK MBARËKOMBËTAR

"I KËNDOJMË LIRISË"



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS

Mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës, **Prof. dr. Zenun Elezaj**

6 QERSHOR NATA E PARË 2026

Çabiq - Ora 11:00

1. FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS PROF. DR. ZENUN ELEZAJ
2. FJALA NGA PËRFAQËSUESI FSHATIT
3. PROGRAMI ARTISTIK
4. SOFRA E ÇABIQIT

Klinë - Ora 19:00

- 18:00 - HAPJA E SOLEMNE E PANAIRIT TË PRODUKTEVE VENDORE
- 18:20 - DEFILIMI I GRUPEVE PJESËMARRËSE NE RRUGËT E KLINËS DERI TEK SHTATORJA E MUJË KRASNIQIT

1. AKV "JEHONA E DUKAGJINIT" - KLINË (MKOGJIR)
2. AKV "KATARINA JOSIPI" - ZYM
3. AKV "DEDË GJON LULI" - TUZ
4. RAPSODI AGRON UKZMAILI ME GRUP
5. RAPSODET ELVIS DHE EGZON KRYEZIU
6. ANSAMBLI "TEUTA" - DURRËS
7. AKV "SHOTË GALICA" - DRENAS
8. RAPSODI LUTFI ISTOGU ME GRUP
9. AKV "JEHONA" - SUHAREKË
10. AKV "HAJVALIA" - PRISHTINË
11. AKV "VULLKANI" - BURIM

7 QERSHOR NATA E DYTË 2026

- 18:20 - DEFILIMI I GRUPEVE PJESËMARRËSE NE RRUGËT E KLINËS DERI TEK SHTATORJA E MUJË KRASNIQIT

- 19:00 - NATA E DYTË E FESTIVALIT


1. AKV "ARDHMERIA" - GJAKOVË
2. AKV "ILIRIDA" - SHTIME
3. RAPSODI EMIN RACAJ
4. RAPSODET ALI LESTRANI DHE BESIM ELSHANI
5. AKV "ZAHIR PAJAZITI" - PODUJEVË
6. AKV "SELMAN KADRIA" - ISTOG
7. RAPSODI NAZMI HAJDARI
8. RAPSODET SYLË DHE AVDYLL KRASNIQI
9. ANSAMBLI AUTOKTON "RUGOVA" - PEJË
10. AKV "KASTRIOTET" - FERIZAJ

8 QERSHOR NATA E TRETË 2026

- 18:20 - DEFILIMI I GRUPEVE PJESËMARRËSE NE RRUGËT E KLINËS DERI TEK SHTATORJA E MUJË KRASNIQIT

- 19:00 - NATA FINALE E FESTIVALIT

1. AKV "HAREA" - PRIZREN
2. QENDRA KULTURORE "ANAMORAVA" - VITI
3. ANSAMBLI "VAÇE ZELA" - FIER, SHEGAN, LUSHNJË
4. AKV "KARADAKU" - GJILAN
5. AKV "GURRA E KURBINIT" - KURBIN
6. GRUPI I BURRAVE - MIRDITË
7. RAPSODI NAIM KRASNIQI
8. THESARET LABE - TIRANË
9. RAPSODET MUHARREM ELSHANI DHE NUREDIN E FATMIR META
10. AKV "DRENICA" - SKENDERAJ
11. SHKA "DUFLLA" - SHKUP



2026

LYRA

REVISTË PERIODIKE E
FESTIVALIT FOLKLORIK
"I KËNDOJMË LIRISË"

6, 7, 8 QERSHOR

**24
VJET
FESTIVAL**



*Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë"
mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës,
Prof, dr, Zenun Elezaj*

TIRAZHI I KËSAJ REVISTE ËSHTË 200 KOPJE